



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rr"Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 30/06/2018

V E N D I M

Nr. 78 , Datë 30/06/2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN E SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR "MBI
PËRPUTHSHMËRINË"
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë" të ushtruar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas programit të auditimit nr. 1346/1 prot, datë 19.01.2018, shkresës nr. 1346/2 prot, datë 15.03.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000¹).

Nga auditimi mbi përputhshmërinë², i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, në administrimin e fondeve të rimbursimit të barnave, në monitorimin e kontratave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, por edhe në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të Fondit.

Evidentohet dobësim i sistemeve të kontrollit gjatë vitit 2017, në të gjitha aspektet e funksionimit të këtij institucioni. Zona më me risk në gjykimin e audituesit të jashtëm vijon të mbetet rimbursimi i barnave, shpenzim që zë një nivel të konsiderueshëm të buxhetit të këtij institucioni. Kemi konstatuar se mungesa e rregullave të qarta e të mirë përcaktuara, në planifikimin e buxhetit, mos ndjekja e shpenzimeve të rimbursimit sipas kategorive përfituese të barnave të rimbursueshme, mos kryerja e analizave të thelluara në rastet e tejkalimeve të theksuara dhe mos kryerja e inspektimeve nga drejtoritë teknike ka çuar në rritje galopante të këtij shpenzimi. Lidhur me këtë, nuk arritëm të krijojmë bindje të arsyeshme që shpenzimi është realizuar në përputhje të plotë me kuadrin rregullativ.

Konstatohet mungesa e një metodologjie të mbështetur në akte ligjore dhe administrative për hartimin e listës së barnave të rimbursueshme. Veprimtaritë e kontrollit paraqiten thuajse inekzistente, si në drejtim të kontrollit të skemës së barnave të rimbursueshme, por edhe të shërbimit të kujdesit parësor. Mungon bashkëpunimi i strukturave të Fondit me organet tatimore dhe me organet e tjera ligjzbatuese për parandalimin e evazionit fiskal dhe veprimtarive të kundërligjshme e abuzive në zbatimin e skemës së detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Parregullsi vërehen gjithashtu në procedurat e rekrutimit dhe në respektimin e dispozitave ligjore e kontraktuale për largimin e punonjësve nga puna, në dokumentimin dhe arkivimin e dokumentacionit të brendshëm, në hartimin dhe zbatimin e kontratave me dhënësit e kontraktuar të shërbimeve shëndetësore, në përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efijencë të fondeve publike.

Vlera e parregullsive me efekte negative për buxhetin e shtetit të konstatuara nga auditimi i veprimtarisë së këtij subjekti për vitin 2017 përlllogaritet në shumën 3,865 milion lekë.

Në gjykimin tonë si auditues të jashtëm, si rezultat i parregullsive dhe mangësive të konstatuara, të cilat janë materiale, të identifikuar dhe trajtuara në këtë raport, FSDKSH nuk garanton përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit. Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë

¹ ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

² Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinioni të kundërt të përputhshmërisë*³.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.Gjetje nga auditimi: KA-ja ka parashikuar me Vendimin Nr. 5, datë 27.01.2017 “Për financimin e paketave të shërbimit të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të ofruara nga shërbimet spitalore publike për vitin 2017”, fondin vjetor për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, në referencë edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 18, datë 11.01.2017. Në relacionin e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm, përcaktohet një marzh për tu shpërndarë gjatë muajve korrik dhe dhjetor, pas verifikimit të sasisë së paketave të realizuara nga spitalet. Me VKA nr. 68, datë 19.12.2017, “Për financimin e paketave të shërbimit të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, të ofruara dhe marzhit të fitimit të tyre”, KA-ja ka vendosur që marzhi i fitimit midis vlerës së paketës dhe kostos së tyre të përdoret nga këto institucione ofruese të shërbimit të paketave, a) për shpërblim deri dy paga mujore për punonjësit e shërbimit që ofron paketat dhe b) për shpenzime për mallra dhe shërbime. Sipas të dhënave vjetore të vëna në dispozicion nga FSDKSH për gjithë vitin 2017, rezulton që marzhi i fitimit për paketat e ofruara nga institucionet publike paraqitet në shumën 80,600 mijë lekë.

Aplikimi i marzhit të fitimit nga ana e FSDKSH, në paketat shëndetësore dhe financimi me këtë marzh i spitaleve publike veç atyre private, vjen në kundërshtim me përcaktimet në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 23, pika 1) përcakton se: “Spitalet publike janë institucione me buxhet të pavarur, **jofitimprurëse** dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mjediset dhe me pajisjet që janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë”. Pra ky marzh fitimi në gjykimin tonë nuk duhet të jetë pjesë e çmimit të paketës që kryejnë institucionet shëndetësore publike, të cilët në veprimtarinë e tyre nuk kanë si qëllim fitimin, por ofrimin e shërbimeve publike.

Nga ana tjetër, shpërndarja e këtij marzhi fitimi prej KA-së për shpërblime të stafëve mjekësore ndërkohë që akte të posaçme ligjore rregullojnë mënyrën dhe kohën e dhënies së tyre, në gjykimin tonë ka dëmtonuar buxhetin e njësisë publike dhe e ka ekspozuar Fondin mes problematikave të tjera ligjore të panevojshme. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1. Rekomandimi: FSDKSH të shqyrtojë mospërputhjet midis pikave 1, 4, 9 të VKM nr. 308, datë 21.05.2014, dhe nenit 23 të Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore me të cilat bien ndesh ky vendim, si dhe të paraqesë propozimet e duhura në Këshillin Administrativ dhe Këshillin e Ministrave për ndryshimin dhe harmonizimin e tyre.

Menjëherë

³ *Opinion i Kundërt, jepet në rastet kur konstatohen anomali materiale dhe të përhapura*

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi:

A. Nga auditimi i shpenzimeve të skemës së rimbursimit të barnave u konstatua se:

- Vendimmarrjet e Këshillit Administrativ në 30 raste të konstatuara, kanë tejkaluar kompetencat e parashikuara për këtë organ, duke miratuar rimbursim të barnave përtej kufizimeve në përdorim, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit, veprim në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, me efekt financiar në shumën **139,490 mijë lekë**. Janë rimbursuar barna të cilat janë të përfshira në listën e barnave të rimbursueshme në fuqi, për rrjedhojë vendimmarrjet e KA-së janë të panevojshme dhe në tejkalim të kompetencave, ndërkohë që procedura e përzgjedhjes së rasteve për rimbursim nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, është diskriminues dhe i pambështetur në ligj. Kjo praktikë i mbivendoset paketës së listës së barnave të rimbursueshme të miratuara nga Këshilli i Ministrave, duke sjellë jo vetëm një hallkë shtesë administrative, por dhe duke kufizuar aksesin e popullatës në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Problematika ka vijuar gjatë muajve të parë të vitit 2017 dhe më pas është ndërprerë si rezultat i konkluzioneve të dala në auditimin e mëparshëm të KLSH, por akti administrativ VKA nr. 70, datë 18.04.2014 nuk rezulton ende i shfuqizuar.

- VKM nr. 380, datë 25.05.2016 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH”, i ndryshuar, në pikën 7 të tij, përcakton se: “...nëse gjatë periudhës kur ky vendim është në fuqi, ulen çmimet për barnat e përgjithshme të listës ose barnat alternative e vetme që tregtohen në farmacitë e spitalit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me njoftim të Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, reflekton uljen e çmimit të barit në listë”. Fondi ka miratuar listën e barnave të rimbursueshme për vitin 2017 dhe e ka dërguar këtë listë në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim në Këshillin e Ministrave. Megjithatë LBR-ja e vitit 2017, nuk është miratuar gjatë këtij viti, për arsye të cilat nuk varen prej Fondit, çmimet e reja duhet të ishin reflektuar rregullisht prej tij, sipas përcaktimit ligjor në pikën nr. 7 të VKM nr. 380, datë 25.05.2016, pasi Fondi është pjesë e Komisionit të Çmimit të Barnave. Mosreflektimi i çmimeve të reja ka sjellë si pasojë kosto shtesë në buxhet, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, në shumën **132,465 mijë lekë**.

-Planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit të barnave është bërë i ndarë sipas kategorive përfituese të rimbursimit, referuar udhëzimit të FONDIT për planifikimin e treguesve buxhetorë, por ato janë çelur në total, pa u ndarë në kategori, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Fondit nr. 4, datë 14.2.2017 ku përcaktohet se: “Në nivel nën artikulli dhe analize, përveç shpenzimeve për investime, detajimi do të kryhet nga Drejtoria Rajonale, apo dega dhe do të dërgohet në Drejtorinë Ekonomike në FOND, në formë elektronike dhe shkresore, brenda datës 20.02.2016”. Çelja dhe detajimi në Drejtorinë Rajonale në rrethë është bërë në total, përveç Drejtorive Rajonale të Durrësit, Fierit, Elbasanit dhe Lushnjës, ku ka një detajim të saktë të rimbursimit sipas kategorive përkatëse. Nga strukturat përkatëse në FOND nuk i është kërkuar njësisive të varësisë, detajimi i shpenzimeve të rimbursimit konform udhëzimit, me qëllim ndjekjen dhe monitorimin e shpenzimeve sipas zërave, pavarësisht se ky zë ka një rritje të konsiderueshme nga viti i kaluar. Nga të dhënat e vëna në dispozicion prej Fondit, për vitin 2017, konstatohet rritje e vlerës së rimbursimit në shumë absolute për 1,991,803 mijë lekë, ndërkohë që nuk kemi ndryshim të çmimit të barnave dhe numri i përfituesve ka rënë me 720 pacientë krahasuar me vitin 2016, edhe pas futjes në skemë të kategorisë 39 “Person me sëmundje kronike”. Vlera prej 1,991,803 mijë lekë, përbën një rritje prej 23.6% të shpenzimeve për rimbursimin e barnave krahasuar me vitin e mëparshëm. Në kushtet e përdorimit të këtyre fondeve jo për qëllimin e parashikuar në buxhet, e shoqëruar nga ulja e numrit të përfituesve në skemë, kur çmimet e LBR-së nuk kanë pësuar ndryshime gjatë kësaj periudhe, ku

numri i recetave është rritur vetëm me 3.4% në krahasim me një vit më parë, mungesës së analizave sektoriale, si dhe në kushtet e mungesës totale të ushtrimit të kontrolleve nga strukturat e Fondit në kundërshtim me dispozitat ligjore të evidentuara gjatë këtij auditimi, tregon më së paku një keqmenaxhim të fondeve publike në vlerën 1,991,803 mijë lekë. Kjo dukuri bëhet më e theksuar prej muajit Qershor 2017 dhe në vazhdim.

- Me vendimin e KA-së nr. 6, datë 27.01.2017 “Për krijimin e Komisionit Teknik të Barnave të Rimbursuara, për vitin 2017”, Këshilli Administrativ ka miratuar komisionin për hartimin e listës LBR 2017. Me shkresën nr. 1398 Prot., datë 21.03.2017 lista e miratuar është dërguar për procedim pranë Ministrisë së Shëndetësisë së bashku me projektvendimin për Këshillin e Ministrave dhe relacionin shoqërues. Lista e Barnave të Rimbursueshme për vitin 2017 megjithëse e miratuar me vendimin e KA-së nr. 42, datë 21.03.2017 dhe e dërguar për procedim të mëtejshëm në Ministrinë e Shëndetësisë nuk rezultoi e miratuar prej Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2017, duke mos hyrë efektivisht në fuqi për asnjë moment. Sipas dokumentacionit të administruar, LBR-ja e vitit 2017 nuk ka hyrë në fuqi si rezultat i mosdakordësive të shprehura midis Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë për aspekte teknike të procedimit nga ana e Fondit në miratimin e paketës së barnave të rimbursueshme. Çmimet CIF të barnave të rimbursueshme të aplikuara në LBR-në 2017 kanë një rënie të përlllogaritur në masën 4.1%, krahasuar me çmimet e aplikuara në LBR-në 2016. Mosmiratimi në kohë i listës së re ka cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm autonominë e Fondit për administrimin e paketave të sigurimit të detyrueshëm, parashikuar në nenin 13, të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por ka krijuar pasoja negative në buxhetin e shtetit në shumën **409,000 mijë lekë**, si dhe ka ndikuar negativisht në vlerat e bashkëpagesës të personave përfitues të skemës.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 19.07.2017 “Për një ndryshim në VKM nr. 380, datë 25.05.2016 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH” është vendosur ndryshimi në rritje i çmimit të barit *Madopar*. Nga auditimi konstatohet se, nga ana e KÇB-së pranë Ministrisë së Shëndetësisë është realizuar një vendimmarrje jashtë përcaktimeve në VKM nr. 645, duke ndjekur një *ekstra-procedurë* për këtë rast. Propozimi i Ministrit të Shëndetësisë në KM, në rastin konkret për një ndryshim në Listën e Barnave të Rimbursueshme jo vetëm e ka anashkaluar Fondin në mënyrë të padrejtë, por e ka vendosur atë përpara faktit të kryer për përballimin e kostove shtesë. Ky rast, në gjykimin tonë përbën një precedent të gabuar, i cili ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit në shumën rreth **6,200 mijë lekë**.

B. Nga auditimi i zbatimit të kontratave nga dhënësit e kontraktuar të shërbimeve u konstatua se:

- Gjatë kontrolleve të ushtruara në subjektet farmaceutike për zbatimin e kontratave F/2016 dhe F/2015, si dhe shtojcës F /2015, grupet e kontrollit kanë pranuar që shkeljet, edhe pse i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në kontratë të mos merren parasysh për zgjidhjet e kontratave, duke i argumentuar si shkelje të cilat i përkasin periudhës së kontratës paraardhëse. Ky interpretim ka sjellë që fenomeni i diferencave të mbyllet me disa gjopa minimale dhe me mbajtjen në muajin pasardhës të shumave të rimbursuara padrejtësisht, *pra* janë mbyllur diferencat në minus dhe plus në inventarët kontabël dhe nga ana e Fondit janë vendosur penalitete të papërfillshme për subjektet kundërvajtës, *ndërsa këto subjekte kanë vazhduar të rimbursohen normalisht nga FSDKSH-ja.* Për 12 farmacitë, të cilat janë kontrolluar nga ana e DKPF-së gjatë vitit 2017 dhe kanë rezultuar me diferenca në *plus* dhe *minus* mbi përcaktimet e parashikuara në kontratën F/2016 dhe Shtojcën, DKP-ja nuk ka marrë masën e ndërprerjes së kontratës, pavarësisht rekomandimeve të lëna edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH-së (për vitin 2016). Mosndërprerja e kontratës dhe rimbursimi i

këtyre farmacive nga ana e FSDKSH-së i bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kontraktuale të kontratës me farmacitë llogaritet në vlerën **144,404 mijë lekë**.

- Në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është bërë kallëzim penal, me objekt: *Kallëzim të kryerjes së veprës penale të “Mashtrimit”, “Mashtrimit në subvencione” dhe “Fallsifikim të Dokumentave Shëndetësore”, për farmacitë: “A....”, “B....”, “C....”, “E....”, “G.....” dhe “.....”.* Referimi i këtyre farmacive për ndjekje penale në Prokurori duhej të ishte bërë shkak për të mos lidhur Kontratën F/2016, e cila ka filluar zbatimin pas hyrjes në fuqi të LBR-së 2016, pra në muajin qershor të vitit 2016, ekzaktësisht dy muaj pas kallëzimit penal të bërë për këto farmaci nga ana e FONDIT. Në kapitullin “Kriteret”, pika 14 e kësaj kontrate, F/2016, përcaktohet se: *“Nuk lidhet kontratë me Farmacitë të cilat janë nën hetim nga organi i akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate deri në përfundimin e plotë të hetimeve”.* Për këtë çështje, edhe pse është trajtuar në auditimin e mëparshëm të ushtruar nga KLSH, nga ana e FONDIT nuk është ndërmarrë asnjë veprim administrativ për ndërprerjen e këtyre kontratave të lidhura padrejtësisht. Rimbursimi i farmacive, për të cilat duhet të ishte marrë masa e ndërprerjes së kontratës nga ana e FONDIT, ka vijuar në kundërshtim me dispozitat e kontratës me farmacitë për periudhën Mars-Dhjetor 2017 dhe arrin shumën **222,581 mijë lekë**.

- Në vazhdimësi është konstatuar moszbatimi i masës për ***ndërprerjen e kontratave*** nga ana e Drejtorisë Rajonale të Fondit Tiranë, për farmacitë që kanë shitur barna që u ka kaluar afati i skadencës të evidentuar në auditimin e mëparshëm, referuar Raportit Përfundimtar të DAB-së në DRF Tiranë. Rekomandimi i lënë nga DAB e FSDKSH-së, por edhe nga KLSH për ***ndërprerjen e menjëhershme të kontratës me këto subjekte***, jo vetëm nuk ka gjetur zbatim nga Drejtoria Rajonale e Fondit Tiranë, e cila duhet të kishte ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale me këto farmaci, por sipas të dhënave për 20 subjekte farmaceutike të rimbursuar në vazhdimësi, për periudhën Mars-Dhjetor 2017, vlera e rimbursuar padrejtësisht arrin shumën **333,104 mijë lekë**.

1.1 Rekomandimi: FSDKSH të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative, për të rregulluar procesin e rimbursimit të barnave, duke eliminuar problematikat e cilësuar më lart, të cilat kanë rritur abuzivitetin me skemën e rimbursimit të barnave, si dhe kanë ndikuar negativisht në cilësinë e vendimmarrjes dhe transparencën në menaxhimin e këtyre fondeve.

1.2 Rekomandimi: FSDKSH të bëjë rishikimet e nevojshme në listën e miratuar së fundmi të rimbursimit të barnave, duke synuar reflektimin e kriterëve të njëjta në përfshirjen në listë të barnave dhe duke eliminuar të metat dhe difektet e listës paraardhëse. Analiza të nisët nga modelet më të përparuara ndërkombëtare, përshtatur me mjedisin shqiptar.

Brenda datës 30.09.2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në FSDKSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr. 264/9, datë 29.09.2017 *“Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, përputhshmëri dhe rregullshmëri financiare e aktivitetit”*, për aktivitetin e vitit 2016, janë lënë për zbatim 28 rekomandime, të cilat janë pranuar nga titullari 28 rekomandime, ose 100% e tyre. *Nga rekomandimet e pranuar janë zbatuar 5 prej tyre, ose 18 %, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 3%, janë në proces zbatimi 11 rekomandime, ose 40 % e tyre dhe nuk janë zbatuar 11 rekomandime, ose 39 % e tyre.*

Përmendim se, në auditimet e mëparshme sipas Vendimeve të Kryetarit të KLSH-së nr. 134, datë 04.10.2016 dhe nr. 129, datë 28.09.2017, është konstatuar problematika në zbatimin e kontratës koncesionare të ***Check up-it***, referuar pagesës së koncesionarit për realizimin e të paktën 475 mijë kontrolleve në vit, ose 39,583 kontrolle në muaj. Megjithë zgjerimin e fashës së popullatës në vijim lidhur me përfitimin e këtij shërbimi, konstatohet se edhe për vitin 2017, nuk është arritur numri prej 39,583 kontrolle të parashikuara në muaj, pasi gjatë kësaj periudhe janë realizuar vetëm 26,383

kontrolle në muaj, kjo ka sjellë që pagesa prej 292,144 mijë lekë (me Tvsh) për 158,395 raste të perealizuara të sjellë një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit.

Ndërkohë që po të ishte vepruar sipas **rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2016, koncesionari duhej të ishte paguar vetëm për vlerën e shpenzimeve fikse për çdo kontroll bazë dhe jo për vlerën e shpenzimeve variabël të parashikuar që llogariten rreth 400 lekë për Check up (pa TVSH), pasi koncesionari nuk ka kosto materiale për këto raste, fakt që do të kishte ulur koston për buxhetin në vlerën 63,358 mijë lekë, (158,395*400) ndërsa për periudhën 2015-2017 kjo parregullsi arrin në shumën **182,098 mijë lekë.****

Në lekë

Nr.	Viti	Mesatare mujore sipas kontratës	Mesatare mujore ne fakt	Nr. Muajsh	Numër kontrollesh sipas kontratës	Numër kontrollesh në fakt	Numër kontrollesh të likujduar	Kontrolle të faturuar por të pakryer	Kosto fikse për njësi (pa TVSH)	Vlera e kostos fikse perfituar padrejtësisht
1	2015	39,583	24,442	10	395,830	244,420	244,420	151,410	400	60,564,000
2	2016	39,583	27,463	12	474,996	329,556	329,556	145,440	400	58,176,000
3	2017	39,583	26,383	12	474,996	316,601	310,123	158,395	400	63,358,000
Shuma					1,345,822	890,577	884,099	455,245	400	182,098,000

Tabela nr.1: Treguesit vjetorë për kostot fikse të kontrolleve të pakryera përfituar padrejtësisht prej koncesionarit.

Shënim: Për vitin 2015, mesatarja mujore e kontrolleve të kryera në fakt, nëse do të zhishej nga 2 muajt e parë të fillimit të implementimit të paketës përkatësisht, muajt Mars dhe Prill, në të cilët janë kryer 4,219 dhe 9,087 kontrolle bazë, do të rezultonte për 28,889 kontrolle në muaj, pra me një performancë mujore më të lartë se vitet pasardhëse 2016, 2017.

Nga auditimi konstatohet se, edhe për vitin 2017, vijon të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore të Check-up, lëshuar nga koncesionari, në vlerën totale 876,083 mijë lekë, në të cilën përfshihet edhe TVSH në masën 20% mbi vlerën e shërbimit shëndetësor, ndërkohë që ky furnizim shërbimi duhet të trajtohet si Furnizim i Përyshuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, sipas përcaktimit ligjor në Nenin 51 pika c) e Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH", i ndryshuar. KLSH i ka rekomanduar FONDIT në auditimin e mëparshëm të kërkojë interpretimin teknik nga DPT lidhur me këtë mënyrë faturimi. Interpretimi i dërguar nga DPT, në gjykimin tonë nuk paraqet frymën e ligjit, si dhe nuk përmbush kërkesat teknike për rastin konkret. Kështu që në gjykimin tonë, vijimi i praktikës së pranimit dhe likuidimit të faturave të Check-up, si një shërbim i tatuashëm me TVSH, vijon të krijojë kosto shtesë në buxhet, që për vitin 2017, llogaritet në shumën 146,014 mijë lekë, ndërsa për periudhën e deritanishme të shtrirjes së kontratës vlera arrin në **413,706 mijë lekë**, si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Viti	Numër kontrollesh sipas kontratës	Çmimi për Check Up (pa TVSH)	Vlera e tatuashme e faturuar	TVSH e llogaritur	Total faturim
1	2015	395,830	1,537	608,390,710	121,678,142	730.068.852
2	2016	474,996	1,537	730,068,852	146,013,770	876.082.622
3	2017	474,996	1,537	730,068,852	146,013,770	876.082.622
Shuma		1.345.822	1537	2,068,528,414	413,705,683	2,482,234,097

Tabela nr.2: Vlera e TVSH-së për shërbimin e Check-up përfituar padrejtësisht nga koncesionari.

Konstatohet se, pavarësisht rritjes së fashës së përfituesve, numri i personave të cilët marrin këtë shërbim nga viti në vit ka pësuar rënie, duke ndikuar në rritjen e pagesave për raste të pakryera nga ana e Fondit. Në total, nga fillimi i kontratës deri në fund të vitit 2017, koncesionari ka përfituar në mënyrë të padrejtë koston fikse të kontrolleve të pakryera për këtë shërbim për 455,245 raste e përkthyer në vlerë 182,098 mijë lekë, si dhe Tvsh-në për shërbimin e faturuar deri tani në vlerën 413,705 mijë lekë. Në total vlera e parregullsive përlllogaritet në shumën 595,804 mijë lekë. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ i FSDKSH dhe Drejtori i Përgjithshëm të rishqyrtojnë Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe të nxjerrin vendimet përkatëse për rekomandimet nr. A/1, A/2, A/3, A/4, A/5, B/1, B/3, B/7, B/8, C/1 dhe D/1, që konsiderohen të pazbatuara dhe konkretisht:

2.1.1 Rekomandimi: I rikërkojmë, FSDKSH-së që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në dakordësi me koncesionarin, të ndryshojë kushtet e kontratës, në mënyrë që përmes modaliteteve shtesë të arrihet masa e kontrolleve mbi të cilat është dakordësuar çmimi i këtij shërbimi. Këshilli i Ministrave nisur nga analiza e faktit që numri i analizave është larg pritshmërisë së numrit të kontraktuar, të shikojë mundësinë e eliminimit të tavanit të sipërm të fashës së përfituesve të check-up, dhe të ndërmarrë rregullime ligjore për të mundësuar zvogëlimin e efekteve negative (pagesa pa shërbim) në këtë koncesion.

2.1.2 Rekomandime (të përsëritura) lidhur me kontratën e Check up-it

Ti kërkohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një amendim i kontratës koncesionare, për rishikimin e paketës Check up-it dhe eliminimin e kostove shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të pagesës së shpenzimeve variabël që llogariten rreth 400 lekë për Check up (pa TVSH) për kontrollin e pakryera. Kjo ndërhyrje të shoqërohet edhe me vendosjen e mekanizmave për një monitorim të cilësisë së shërbimit të ofruar duke synuar rritjen e besueshmërisë së popullatës në mënyrë që ky koncesion të përmbushë objektivat për të cilin u ofrua nga qeveria.

Pjesë e amendimit të jetë edhe saktësimi i shërbimit të ofruar në këtë kontratë si një shërbim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerë e shtuara TVSH.

Brenda datës 30.09.2018

2.1.3 Rekomandime (të përsëritura) në lidhje me Ndryshimet e Legjislacionit në fuqi:

- Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së dhe KA të shqyrtojnë dhe të përmirësojnë kuadrin rregullator për të mundësuar futjen e elementëve që do ta bëjnë më atraktive skemën e sigurimit shëndetësor, duke synuar njëkohësisht edhe funksionalitetin e saj

Fondi, të marrë masat e duhura për përcaktimin në rregulloret e tij të detyrave konkrete për drejtoritë dhe sektorët në varësi të tyre me afate të përcaktuara, për hartimin, miratimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, të raporteve vjetore të konsoliduara dhe relacioneve përkatëse në lidhje me veprimtarinë e Fondit.

- Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së të propozojë në Këshillin Administrativ shfuqizimin e VKM nr. 560, datë 23.10.2000, “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar dhe trajtimin e këtij spitali si gjithë sistemi spitalor publik në vend.

- FSDKSH me qëllim parandalimin dhe korrigjimin e veprimtarive të kundërligjshme dhe abuzive nga dhënësit e kontraktuar të shërbimeve shëndetësore, të rishikojë klauzolat e mësipërme të Kontratës së farmacive F/2016, të pjesës “Detyrimet specifike”, duke hequr kufizimin “...jo më tej se afati i kontratës paraardhëse...” dhe fjalët “...përjashtojë ndërprerjen e kontratës”, duke lënë si detyrim që “kontrolli me inventar të fillojë nga momenti kur ka përfunduar kontrolli i fundit i inventarit”.

- Kontrata tip me farmacitë të ketë një bazë ligjore të mirë plotësuar, ku të përfshihen detyrimisht ligjet e sipërcituara. Rinovimi i kontratave për subjektet të cilat nuk janë evidentuar me shkelje (të çdo lloji) të bëhet në mënyrë automatike nga sistemi informatik.

Brenda vitit 2018

2.1.4 Rekomandime (të përsëritura) në lidhje me Masat Organizative

- Titullari i institucionit të marrë masa për hartimin e deklaratës mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm së bashku me pyetëtorin e vetëvlerësimit dhe depozitimin e tyre në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.
- Institucioni të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë vlerësimin e punës së punonjësve.
- Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masa për të hartuar gjurmët e auditimit dhe gjurmët e prokurimeve publike, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.
- Titullari i institucionit, të marrë masa për të trajnuar stafet lidhur me kërkesat e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Të merren masa të menjëhershme që të eliminohen praktikat e konstatuara lidhur me funksionalitetin e Këshillit Administrativ kjo, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale të kësaj strukture.
- Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të shfuqizojë shkresën nr. 312 Prot., datë 27.01.2015 të ish Drejtorit të Përgjithshëm dhe të heqë kufizimin e kontrollit vetëm nga DKPF-ja e Fondit për subjektet me vlerë rimbursimi mujor të barabartë ose më të lartë se 2,000,000 lekë
- DKPF-ja të kontrollojë subjektet e parashikuara në planin vjetor, bazuar në analizën e riskut dhe në kriteret të mirë përcaktuara si dhe të kontrollojë të gjitha subjektet e pakontrolluara gjatë vitit 2016, të cilat kanë përfituar rimbursim të barnave.
- FSDKSH-ja, të njoftojë strukturat e varësisë, për verifikimin e të gjitha kontratave në fuqi, si dhe të nisin procedurat ligjore për ndërprerjen e kontratave që bien ndesh me përcaktimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”. Për rastet e konstatuara, të njoftohet edhe Qendra Kombëtare e Biznesit. FSDKSH në të gjitha rastet kur subjektet janë nën hetim apo në proces gjyqësor të ndërpresë marrëdhëniet kontraktuale me këto subjekte sipas përcaktimeve në kontratën tip me farmacitë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.5 Rekomandime (të përsëritura) në lidhje me Masat Shpërblim Dëmi

FSDKSH të verifikojë në vijimësi procedurat dhe veprimet e kryera nga ana e DRF –Tiranë për ndërprerjen e kontratave me farmacitë, trajtuar në Raportit Përfundimtar të Auditimit, fq. 106 “Rekomandimet”, gjetja nr. 14, të mbajtur për këtë drejtori rajonale, marrjen e masave ligjore për arkëtimin e masave zhdëmtuese dhe zbatimin në kohë dhe me efikasitet të rekomandimeve të lëna prej DAB-së. FSDKSH të nisë procedurat ligjore për masë zhdëmtimi si shtesë në Raportin Përfundimtar të Auditimit të DAB-së për Farmacinë “G...”, në shumën 1,408,980 lekë. FSDKSH të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet të cilët kanë përfituar padrejtësisht rimbursim të suplementeve, me të gjithë specifikimet e nevojshme, shumat, faturat tatimore, etj., të cilat janë likuiduar prej saj, për llogaritjen dhe mbledhjen në buxhet të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.6 Rekomandime (të përsëritura) në lidhje me Masat për Eliminimin e Efekteve Negative në Buxhet

FSDKSH-ja të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve informacion të plotë për ndjekje të mëtejshme të diferencave inventariale të konstatuara në subjektet e kontrolluara nga DKPF-ja, si dhe të dërgojë në vazhdimësi në organet përkatëse ligj zbatuese informacionet për diferencat dhe parregullsi të tjera, të konstatuara nga strukturat e FONDIT në lidhje me kontrollin e kryera prej tyre. FSDKSH dhe Drejtoritë Rajonale të saj, për të gjitha rastet e konstatuara me diferenca

inventariale mbi kufijtë e përcaktuar në kontratë, të marrin masën e zgjidhjes së kontratës, pavarësisht nga periudha për të cilën konstatohen diferencat në plus ose në minus.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Administrativ të Fondit, datë 19.05.2017, sipas procesverbalit të mbledhjes nga Zj. O.M, si Kryetar i KA-së është propozuar si kandidaturë e vetme për funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm, **Z. E.....**, i miratuar në unanimitet prej anëtarëve pjesëmarrës, pa votim të fshehtë. Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm nga ana e KA-së në kushte të paqena të situatave të “jashtëzakonshme” nëpërmjet një kandidature të vetme, moskryerja e verifikimeve paraprake për përmbushjen e kritereve të parashikuara në ligj nga ana e kandidatit për këtë post të rëndësishëm publik, si dhe mosaplikimi i procedurës të zgjedhjes me votim të fshehtë, e bëjnë këtë procedurë të kundërligjshme dhe në thyerje të hapur të dispozitave të procedurës dhe ligjit material, përkatësisht të pikës 1) dhe 2) të nenit 19 të Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 9, të VKM-së Nr. 124, datë. 5.3.2014 “Për Miratimin e Statutit të FSDKSH”, i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ si organi më i lartë vendimmarrës, të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë dhe administrativë, për këtë emërim të kryer në kundërshtim me ligjin dhe sjelljen e funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm në kornizën e parashikuar ligjore.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Në listën LBR 2016, e cila ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2017 për barnat spitalore, bari alternativë e parë me kod 123/96 *Somatropine 5 mg (15 Nj.N)* e firmës *P.....* ka çmim total *12,830.5 lekë* dhe vlerë që rimburohet nga Fondi *12,189 lekë*. Ky bar, ka si alternativë zëvendësuese barin me kod 123/93 *Somatropine 5 mg (15 Nj.N)* i kompanisë *N.....*, me çmim total *14,409.5 lekë* dhe çmim rimbursimi *12,189 lekë*. Nga krahasimi i këtyre dy alternativave zëvendësuese në LBR me të dhënat në regjistrin e barnave u konstatua se, formë/dozat e paraqitura në regjistrin e barnave për këto barna janë të ndryshme, ku formë/doza 5.3 mg/1ml me kod 123/96 e firmës *P....* është paraqitur në Listën e Barnave të rimbursueshme si formë/dozë 5 mg/1ml, duke u renditur padrejtësisht si alternativë e parë në listë, megjithëse nuk duhet të ishte renditur e tillë. Rimbursimi i realizuar prej Fondit duke paguar një formë/dozë prej 5.3 mg/1 ml si 5 mg/1ml jo vetëm ka keq klasifikuar grupimin e barit, por ka sjellë si pasojë pagesa të tepërta për 0.3 g/1ml për çdo njësi të likuiduar, pasi formë/doza që mbulohet nga Fondi është vetëm 5mg/1ml. Sasia e rimbursuar për Barin me kod 123/96 e firmës *P....* dhe formë/dozën reale 5,3 mg/1ml është 734 njësi në vlerën 9,417,587 lekë. Efekti financiar i paguar padrejtësisht nga Fondi si rrjedhojë e përcaktimit të gabuar të formë/dozës për vitin 2017 dhe grupimi i gabuar i tyre llogaritet në *533,071 lekë*. Ky efekt për vitin 2016 mbi bazën e konsumeve të disponuara për një sasi prej 402 barnash të rimbursuar, me vlerë 5,157,861 lekë, llogaritet në shumën *291,954 lekë* dhe në total për vitet 2016 dhe 2017, duke qenë se lista e barnave nuk ka ndryshuar, pagesat e realizuara në tejkalim të vlerës së mbuluar nga Fondi janë **825 mijë lekë**.

- Nga auditimi me zgjedhje në LBR 2016, e cila ka vijuar efektet e saj edhe në vitin 2017 përkatësisht Grupin C03 “Diuretikët” konstatohet se, bari Furosemide *10m g/ml-2ml* nuk rezulton i regjistruar në listën e paraqitur prej komisionit të çmimeve. Në LBR 2016, e cila është ndërtuar për efektin financiar mbi bazën e çmimeve CIF 2016 rezulton i regjistruar vetëm bari Furosemide *20 mg/ml-2ml*, me formë/dozë 50% më të vogël të përmbajtjes së principit aktiv, se bari i pasqyruar për rimbursim prej FONDIT në listë. Po kështu, alternativa e parë e renditur në listë Furosemide

10m g/ml-2ml “Tre. Për Inj” me kodin 66/346 i Firmës S..... nuk rezulton i regjistruar në listën e çmimeve CIF 2016, vënë në dispozicion prej FONDIT, duke u klasifikuar padrejtësisht si alternativë e parë në listë. Në regjistrin e barnave dhe çmimeve të tyre vërejmë që paraqiten barna, të cilat kanë çmime më të ulëta për të njëjtën formë/dozë 20mg/2ml, që duhet të vlerësoheshin prej komisionit gjatë hartimit të LBR, lidhur edhe me raportin kosto/efektivitet. Po kështu, në LBR 2017, ky bar është paraqitur në formë/dozën 20mg/ml, ndërkohë që sipas listës së çmimeve CIF 2017 formë/doza e tij është 10 mg/ml. Pra, FONDI mbulon në skemë një formë/dozë më të ulët, ndërkohë që realisht paguhet çmimi i një formë/doze 2-herë më të madhe. Alternativa e parë në listë e përfshirë gjatë vitit 2017, me çmimin 17.6 lekë e barit me emrin tregtar *Furosemid Alkaloid*, nuk është miratuar në listën e vitit 2016, megjithëse ky bar ishte i regjistruar. Është përfshirë në listë bari *Furosemide Lavoisier*, i cili është bar vetëm për përdorim spitalor sipas përmbajtjes së autorizimit të tregtimit. Nuk rezulton e respektuar gjithashtu, përfshirja në listë e alternativave më pak të kushtueshme sipas barnave të cilët zotërojnë autorizim tregtimi. Këto elemente, prej komisionit teknik të barnave duhet të trajtoheshin në mënyrë specifike për çdo bar dhe grup barnash, për përfshirjen në listë të alternativave të duhura duke garantuar, përdorimin e kriterëve të njëjta jo-diskriminuese, konkurrencën e ndershme dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike, pa cënuar cilësinë e shërbimit të ofruar.

- Nga auditimi mbi hartimin e listës së barnave të rimbursueshme për vitin 2017 rezultoi se,

1. Përcaktimi i çmimeve, masës së mbulimit dhe marzhet e fitimit të barnave të listës nuk realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar dhe standarde të FONDIT. Mungojnë akte të tjera ligjore dhe administrative, për mënyrën e hartimit të saj, duke e lënë këtë proces të rëndësishëm me impakt të madh financiar, si dhe me një ndjeshmëri të lartë publike në gjykime subjektive rast pas rasti dhe të papërcaktuara me kriterë të qarta, gjë e cila e ka ekspozuar njësinë drejt një risku të lartë.

2. Komisioni teknik, nuk ka hartuar dhe miratuar listën e plotë të rimbursimit të barnave, sikurse përcaktohet në aktet ligjore në fuqi, por ka realizuar vendimmarrje vetëm për disa ndryshime të listës së mëparshme të miratuar. Në vendimin e marrë prej komisionit teknik mungojnë të dhënat për numrin e barnave ekzistues, atyre që shtohen, numrin e barnave që hiqen, si dhe nuk pasqyrohet numri total i barnave të listës. Në vendimin e komisionit paraqiten të dhëna të përmbledhura dhe pa asnjë specifikim mbi origjinën, kompaninë, çmimin etj. Komisioni teknik rezulton të ketë bërë një punë të pjesshme dhe nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe VKA nr. 6, datë 27.01.2017.

3. Lista e barnave për vitin 2017 dhe Pasqyrat shoqëruese (I dhe II) për masën e mbulimit dhe nivelin e marzhit, të paraqitura në KA, nuk rezultojnë të firmosura nga ana e komisionit teknik, duke e bërë këtë listë efektivisht të pamiruar prej tij.

4. Në përbërjen e Komisioneve teknike për hartimin e LBR nuk janë përfshirë përfaqësues të grupeve të interesit, pedagogë të shkencave ekonomike, mjekësore dhe sociale, etj., kjo jo sipas përcaktimeve në statutin e FONDIT, neni 18 i tij, duke e bërë këtë një proces të mbyllur, i cili nuk pasqyron transparencë dhe gjithpërfshirje.

5. Në vendimin e komisionit teknik nr.1, datë 20.03.2017 për LBR 2017, regjistruar në FOND me nr. 1371 prot., datë 20.03.2017, nuk specifikohet fakti pse për 48 barna, sipas pikave C dhe D të tij janë marrë si referencë për përcaktimin e çmimit në listë çmimi CIF 2016 dhe jo CIF 2017, në mënyrë të paargumentuar dhe të pa mbështetur me akte ligjore.

6. Është miratuar në mënyrë të paargumentuar kalimi nga nivelet e marzhit të fitimit më të ulëta në nivelet e marzhit më të larta nga ana e komisionit dhe shpjegimi i DP në relacionin drejtuar KA-së se ky kalim bëhet si rrjedhojë e uljes së çmimeve të barnave, sjellë si pasojë likuidime në vlera më të larta të barnave nga ana e Fondit, gjë e cila vjen në kundërshtim të hapur me kriteret e

mirëmenaxhimit të fondeve publike dhe përdorimit me efektivitet, ekonomikitet dhe efijencë të tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandimi: FSDKSH të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative për të rregulluar procesin e hartimit të listës, duke përfshirë në komisionet teknike grupet e interesit dhe të gjitha kategoritë e parashikuara në aktet ligjore, për të eliminuar diskriminimin e rritur cilësinë në vendimmarrje.

Brenda datës 30.09.2018

5. Gjetje nga auditimi: Me VKA nr. 71, datë 21.12.2017, Këshilli Administrativ ka miratuar paketën shëndetësore të “*kataraktës së syrit*”, me një kosto prej 20,157 lekë. Efekti financiar për 2,500 raste të parashikuara shkon në 50,392 mijë lekë. Lidhur me këtë paketë konstatohet se:

- Përpara ngritjes së komisionit teknik të paketave nga ana e Fondit dhe nisjes së një procedure hartimi të paketës së shërbimit shëndetësor, sipas kërkesave të propozuara të ardhura nga shefat e shërbimeve spitalore, nuk kryhet një analizë paraprake nga strukturat përkatëse të tij, për të evidentuar nevojat për këtë shërbim, kapacitetet e ofrimit të këtyre shërbimeve nga institucionet shëndetësore publike dhe private, si dhe çmimet e aplikuara në institucione private apo burime të ndryshme informacioni, të dhëna të cilat mund të sigurohen prej FONDIT.

- Nuk shfrytëzohen plotësisht kapacitetet në drejtoritë përkatëse dhe mundësitë e brendshme të Fondit për analizimin paraprak të zhvillimeve të skemës, duke i kthyer këto drejtori në role monitoruese pas faktit dhe jo pjesë integrale për zhvillimin, ecurinë dhe konsolidimin e skemës

- Nuk realizohet një përlllogaritje paraprake e efektit financiar të prishëm nga Drejtoritë përkatëse, nëse FONDI mund ta përballojë financiarisht mbulimin e një pakete të tillë. Burimet njerëzore të FONDIT që angazhohen në hartimin e paketave mund rezultojnë joefektive, siç është rasti i paketës së “*Impiantit Koklear*”, i cili ka rezultuar me 0 (zero) raste të realizuar gjatë vitit 2017.

- Komisionet e hartimit të paketave, në llogaritjen e kostove kanë përfshirë edhe amortizimin e aparaturave e pajisjeve të spitalit, të cilat sipas Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 23 pika 1) ku përcaktohet se: “*Spitalet publike janë institucione me buxhet të pavarur, jofitimprurëse dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mjediset dhe me pajisjet që janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë*”. Llogaritja e amortizimit në këtë rast nga ana e Fondit nuk është e saktë për sa kohë këto pajisje janë pronë e MSH-së dhe janë pjesë e bilancit kontabël të saj.

- Marzhi i fitimit në masën prej 8% për këtë paketë shëndetësore, referuar relacioneve të Komisionit Teknik, por edhe Projektvendimit të propozuar nga ana e KA-së në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim pranë Këshillit të Ministrave, nuk rezulton të jetë pjesë e propozimit të FONDIT, megjithatë ky marzh fitimi rezulton i përfshirë në VKM-në nr .815, datë 29.12.2017, duke rënduar koston financiare të cilën duhet të përballojë FONDI në vijim për këtë paketë, por jo vetëm. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1 Rekomandimi: FSDKSH përpara se të ndërmarrë hapa konkretë për hartimin e paketave shëndetësore, të realizojë nëpërmjet drejtorive specifike analiza paraprake për shërbimet e reja që do të ofrohen, llogaritjen e mbulimit financiar të tyre dhe të ndërtojë një metodologji të qartë të llogaritjes së koston, duke shmangur koston të cilat nuk përballohen efektivisht nga këto institucione publike ofruese të shërbimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në të dy vendimet e KA-së “Për krijimin e komisionit teknik të barnave të rimbursuara”, për vitin 2017 dhe 2018, janë caktuar anëtarë të këtyre komisioneve vetëm punonjës të institucioneve publike. Baza ligjore e vendimeve për caktimin e komisioneve teknike i referohet nenit 10, pika 4 dhe neni 20 (gërma g), e Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcakton se, përbërja nominative e komisioneve teknike caktohet nga KA-ja e FONDIT, sipas rregullave të përcaktuara në Statut, i cili në nenin 18 të tij, përcakton veç të tjerash se, përbërjet e komisioneve teknike do të jenë me *punonjës të Fondit, të Ministrisë së Shëndetësisë, të institucioneve të tjera shëndetësore, pedagogë të shkencave ekonomike, mjekësore ose sociale, përfaqësues të grupeve të interesit etj.* Gjithashtu Drejtori i Përgjithshëm duhet t’u kërkojë institucioneve që mund të përfshihen në procesin e hartimit të paketave, që të paraqesin kandidatura për anëtarë të komisioneve teknike. Në dosjen përkatëse dhe relacionin shoqërues të vendimit nuk përshkruhet asnjë kërkesë prej Drejtorit të Përgjithshëm drejtuar grupeve të interesit për propozimet e tyre për anëtarë të komisioneve teknike, si dhe përgjigjet e këtyre institucioneve. Heqja e të drejtës për të gjitha palëve e interesit për pjesëmarrjen në këtë proces me ndjeshmëri mjaft të lartë publike, por dhe me ndikim të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit në gjykimin tonë dëmton rëndë transparencën e të gjithë procesit dhe ndikon negativisht në cilësinë e tij.

Në mbledhjen e KA-së të datës 27.01.2017 është trajtuar dhe relacioni i Drejtorit të Përgjithshëm “Mbi shtesën e kontratës për financimin e koncesionarit lidhur ndërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe shoqërisë P... SHPK”. Ministria e Shëndetësisë ka lidhur me koncesionarin një shtesë mbi kontratën bazë, të lidhur në muajin Janar 2015. Kjo shtesë kontrate koncesioni është nënshkruar nga palët më datë 30.11.2016, nëpërmjet së cilës janë bërë ndryshimet në kontratën bazë përkatësisht, në Aneksin nr. 7 dhe Aneksin nr. 12 të saj, sipas përcaktimeve në VKM nr. 721, datë 12.10.2016 “Për disa shtesa në VKM nr. 185, datë 02.04.2014”. Ndryshimet në kontratën e koncesionit janë përkatësisht: *Grupmoshat 40-65 vjeç zëvendësohet me Grupmoshat 35-70 vjeç; Po kështu janë shtuar edhe 2 analiza shtesë vii) urea dhe viii) kreatinina.* Ndryshimet në Aneksin 7 të kontratës paraqiten si vijon: “Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit në rast se në një vit të plotë të zbatimit të kontratës së koncesionit kryhen më shumë se 475,000 analiza, vlera financiare e analizave të kryera më tepër se 475,000, të kompensohet me vlerën financiare të pakryera në vitet e mëparshme të zbatimit të kontratës, por të paguara në përmbushje të detyrimit për të garantuar pagesën e 475,000 kontrolleve dhe ky kompensim të mos ketë kufizim deri në datën e lidhjes së kësaj shtese kontrate”.

Në vijim të ndryshimeve të kryera në kontratën bazë, Fondi rregullisht duhet të përfshinte ndryshimet edhe në “Kontratën për financimin e koncesionit” të lidhur midis FSDKSH dhe koncesionarit, por faktikisht në kontratën me Fondin janë pasqyruar vetëm përshkrimet e referencave të kontratës së lidhur dhe jo ndryshimet përkatëse të miratuara. Mosreflektimi i ndryshimeve të reja në kontratën e financimit të cilat janë miratuar midis MSH-së dhe koncesionarit, krijon ose mund të krijojë paqartësi në zbatimin e saj nga punonjësit e FONDIT dhe rrit riskun në përdorimin e fondeve publike. Në mënyrën e kontraktuar ky ndryshim në kontratën bazë ka reflektuar pjesërisht rekomandimet e KLSH-së, pasi është marrë në konsideratë zgjerimi i fashës, por nuk është reflektuar rekomandimi për moskryerjen e pagesave për punë të pakryer brenda kufirit të 475,000 kontrolleve bazë. Mosreflektimi ndaj rekomandimeve të KLSH-së ka krijuar dhe vazhdon të krijojë efekte financiare negative të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6.1 Rekomandimi: FSDKSH të reflektojë në kontratën e financimit ndryshimet përkatëse të miratuara për eliminimin e paqartësive në monitorimin dhe zbatimin korrekt të tyre.

Brenda datës 30.09.2018

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, në Sektorin e Kontrollit të Farmacive si dhe në Sektorin e Kontrollit të Depove Farmaceutike konstatohet se:

- Mungesa e planeve të punës mujorë dhe vjetorë për këtë sektor për vitin 2017, ka sjellë mosplanifikim të saktë të subjekteve për kontroll, kryesisht Qendrave Shëndetësore sipas rajoneve që paraqesin risk për shkak të fondeve të shpenzuara. Është konstatuar mosrealizimi i kontrolleve në rajonet e Dibrës, Elbasanit, Durrësit dhe Korçës, të planifikuara prej vitit 2016 dhe të pakryera edhe për vitin 2017, megjithëse këto rajone paraqiten me tejkalim në shpenzimet e rimbursimit. Në programet e kontrollit nuk përcaktohet qartë afati kohor që do të kontrollohet çdo qendër shëndetësore, por vendoset i njëjti afat kontrolli për gjithë qendrat shëndetësore të rajonit. Në disa kontrole të realizuara në qendrat shëndetësore, dokumentacioni i kontrollit është hartuar dhe nënshkruar nga specialistë, që sipas programit të miratuar nuk kanë qenë pjesë e grupit të kontrollit.

- Për periudhën objekt auditimi nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë kontroll tek Mjekët Specialistë që ofrojnë shërbim në kujdesin shëndetësor parësor dhe që kanë kontratë me Qendrat Shëndetësore.

- Mungesa e planeve mujore dhe vjetore, ka bërë që mos të realizohet asnjë kontroll nga Sektori i Farmacive dhe Agjencive Farmaceutike për periudhën Qershor - Tetor 2017. Nuk është kryer asnjë kontroll i plotë inventari në farmacitë e shërbimeve në QSUT, si dhe në asnjë prej farmacive të spitaleve rajonale, të cilat kanë peshën kryesore në shpenzimet e rimbursimit. Pra, si planifikimi dhe realizimi i kontrolleve në farmaci nuk është mbështetur në analizën e riskut, veprime që kanë sjellë jo vetëm mospërdorim të burimeve njerëzore me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë, por ajo që duhet të theksojmë është lënia jashtë kontrollit e farmacive që marrin dhe pjesën më të madhe të rimbursimeve, ose favorizimi i tyre.

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2017, nga Drejtoria e Kontrollit Parësor e Farmaceutik nuk është ushtruar asnjë kontroll inventari në depot importuese që kanë kontratë dypalëshe (Fondi-Depo Importuese), në depot importuese që kanë furnizuar farmacinë e QSUT-së bazuar në kontratën trepalëshe Fondi-QSUT(farmacia)-D/Importuese, ndërkohë që janë zbatuar 11 kontrata për vitin 2016/2017. Mungesa e planeve mujore dhe vjetore, si për çdo sektor të DKPF-së edhe në sektorin e kontrollit të depove farmaceutike, ka rezultuar me një punë të këtij sektori vetëm në muajt Mars, Gusht, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor, pra vetëm 5 (pesë) muaj të vitit, ndërsa për një periudhë 7 (shtatë) mujore, ky sektor ka qenë jo vetëm inekzistent, por dhe njëkohësisht ineffiçient në punën e kryer, ndërsa sistemi jashtë kontrollit shtetëror. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 85-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit Parësor, të marrë masa të hartohen dhe miratohen për çdo muaj planet e punës dhe të realizohen kontrollet në rajonet me risk të lartë, të cilët zënë peshë të madhe në shpenzimet e rimbursimit dhe kanë një periudhë të gjatë pa u kontrolluar, si dhe të realizohen kontrole në Mjekët Specialistë të Qendrave Shëndetësore, të kontraktuar nga Fondi në këto rajone. Të gjithë dokumentet e brendshme të hartuara në Fond, të kenë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, sipas përcaktimeve në Nenet 13,19 të Normave Teknike Profesionale për Arkivat.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Në programet e kontrollit të Qendrave Shëndetësore, të përcaktohet afat i kontrollit për secilën qendër të kontraktuar nga drejtoritë rajonale. Drejtori i Drejtorisë të bëjë miratimin e raportit të kontrollit dhe vlerësimin e cilësisë së kontrollit, duke eliminuar konfliktin e interesit, që mund të shfaqet në rastet kur ai është pjesë e grupit të kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3 Rekomandimi: DKP-ja në zbatim të detyrimeve ligjore dhe nënligjore, të bashkërendojnë punën me strukturat rajonale të Fondit, me qëllim përgatitjen e treguesve statistikorë të konsoliduar për kontrollet e ushtruara, për konstatimet e evidentuara dhe rekomandimet e lëna, në mënyrë që të mundësohet mbulimi i plotë me kontrolle të subjekteve të kontraktuara, të mënjanohet mbivendosja e kontrolleve, si dhe të realizohet mbikëqyrja dhe kontrolli i punës së strukturave vartëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në udhëzimet e Fondit *për hartimin dhe zbatimin e buxhetit* përcaktohet se ky proces ndjek rrjedhën e Udhëzimeve të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, por konstatohet se edhe pse buxheti i fondit përbëhet nga dy programe buxhetore, nuk janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP-et), si për hartimin e PBA e projektbuxhetit të vitit dhe për zbatimin dhe monitorimin e tij, me arsyetimin se në EMP-et e ngritura në Ministrinë e Shëndetësisë janë 4 përfaqësues të Fondit. PBA dhe projektbuxheti nuk janë diskutuar dhe miratuar në GMS, po kështu dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, në moszbatim të kërkesave të ligjit organik të buxhetit dhe të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Miratimi i PBA është bërë në muajin shtator 2016, ndërkohë që Fondi më datë 31.08.2016 e ka dërguar atë në Ministrinë e Financës, pra miratimi është bërë formalisht, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 8, datë 27.02.2015 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, ku përcaktohet: *Mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjësitë për hartimin e kërkesave buxhetore duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues tek drejtuesit e programeve/nëpunësit autorizues të nivelit të dytë, e më tej, nëpërmjet një sistemi delegimesh/ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Gjithashtu, nëpunësi autorizues ngarkon nëpunësin zbatues dhe strukturën përgjegjëse të prokurimeve të njësisë për hartimin e planit të arkës. Çdo nëpunës duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij në këtë proces. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 125-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: Nga FSDKSH të merren masa të menjëhershme për ngritjen dhe funksionimin e EMP-eve, për të dy programet buxhetore që administrojnë, me qëllim hartimin dhe monitorimin e buxhetit të tyre, konform dhe me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Kreu I, Pika 6.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lëvizjeve të bankave me të cilat operon Fondi dhe zbatimit të kontratave u konstatua shlyerja me vonesë e faturave dhe detyrimeve kontraktuale me operatorët ekonomik, për blerjet e mallrave dhe shërbime, konkretisht një likuidim i përkiste vitit 2015, me vlerë 543 mijë lekë, 17 likuidime që i përkisnin vitit 2016, me vlerë 159,685 mijë lekë dhe 9 likuidime që i përkisnin vitit 2017 me vlerë 30,313 mijë lekë, shlyer me vonesë mbi 30 ditë. Sipas afatit të përcaktuar në kontratat e lidhura midis palëve, por vlerësuar mbi kushtin lehtësues 60 ditë kalendarike vonesë sipas ligjit nr. 48,2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, në kundërshtim me Nenin 7 “Afati për autoritetet publike” afatin e shlyerjes së parashikuar në kontratat e lidhura midis operatorëve dhe Fondit, duke sjellë një rritje të detyrimeve të prapambetura (konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykatë i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës), në kushtet nëse midis palëve nuk do të kishte një kontratë në drejtim të shlyerjes 13 furnitorëve, 26 likuidimeve dhe 55 faturave në vitin 2017, me vlerë 190,541 mijë lekë. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 160-199 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1 Rekomandimi: FSDKSH të marrë masa për të parandaluar krijimin dhe akumulimin e mëtejshëm të detyrimeve të prapambetura, të cilat krijojnë vështirësi në shlyerjen së tyre brenda buxhetin vjetor, duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha procedurat e prokurimit për blerjen e mallrave apo të shërbimeve, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” nga AK është kërkuar: “Për të përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të ketë të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare furnizime të ngjashme, me vlerë prej jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit” kriteri i cili është vendosur në kundërshtim me kërkesat e LPP. Për të vërtetuar furnizimet e ngjashme AK ka kërkuar “Kur furnizimet janë realizuar nga institucionet shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë. “kontratë të lidhur, si dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Gjithashtu, nga AK, njësia e prokurimit janë vendosur dhe kriteret të tjera kualifikuese të gabuara (për numrin e fuqisë punëtore, për deklarata të distributorëve) për të cilat nga OE janë paraqitur ankime si pranë AK dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sikurse është rasti i procedurës së prokurimit “Blerje toner për printer dhe fotokopje”, “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve”, apo dhe i procedurës së anuluar “Blerjen e kartave të shëndetit”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Vendosja e kriterëve të gabuara të kualifikimit bie në kundërshtim dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 20 dhe 46 të tij. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 199-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

10.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit pranë AK të tregojë vëmendjen e duhur në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në zhvillimin e procedurave të prokurimit, për të garantuar parimet mbi të cilat zhvillohen procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: FSDKSH nuk ka hartuar rregulla dhe procedura të proceseve të teknologjisë së informacionit. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell ekspozimin e Fondit drejt veprimtari jo konform procedurave të përcaktuara, duke rritur riskun e rritjes së kohës së përgjigjes dhe komunikimit midis hallkave zbatuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 23, “Informacioni dhe komunikimi”, në funksion të një komunikimi efektiv në të gjitha nivelet e hierarkisë së Fondit. U konstatuan mangësi të strukturave të Auditimit të Brendshëm në FSDKSH në drejtim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit, si rezultat i mungesës të kapaciteteve njerëzore, duke rritur mundësinë e rritjes së riskut të mosidentifikimit të parregullsisive në sistemet IT. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 206-237 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

11.1 Rekomandimi: FSDKSH të krijojë një bazë rregullatore për informacionin dhe komunikimin, nëpërmjet të cilës të përcaktohen për gjithë stafin, përgjegjësitë në lidhje me kontrollin, si të trajtojnë jo vetëm të dhëna të krijuara nga brenda, por edhe informacion për ngjarje të jashtme, aktivitete dhe kushte të nevojshme, për të marrë vendime të mirë informuara dhe për raportim të jashtëm duke siguruar gjurmën e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua mungesa e miratimit dhe arkivimit të gjurmës së auditit në Fond, e cila duhet të përgatitet për proceset kryesore të punës. Nuk ka të miratuar

rregjistrin e riskut për vitin 2017, rrjedhimisht nuk është përditësuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 16, pika 2, si dhe mbështetur në shtojcën V. të Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 8980 datë 15.07.2010, të cilat çënojnë nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme, si dhe shtojnë pasigurinë dhe rrezikun e mostrajtit të çështjeve kryesore që mund të kërkojnë ndërhyrje për përmirësim. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 206-237 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

12.1 Rekomandimi: FSDKSH të krijojë dhe miratojë gjurmë të auditimit dhe regjistër risku të përditësuar në funksion të rindërtimit të transaksioneve dhe operacioneve të Fondit, në kuadër të ndjekjes së proceseve të punës, renditjes sipas rëndësisë dhe realizimit të verifikimit të tyre.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit me Rregulloren e Përgjithshme për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës të FSDKSH-së, Strukturës Organizative të Fondit, të hartuar në zbatim të kësaj rregullore, Kapitulli 3.3, “Rregullorja e Personelit”, ndryshuar me urdhrin Nr. 186, datë Nr. 29.04.2017, u konstatua se:

- Ndryshimet e bëra në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme, në drejtori dhe sektorët brenda tyre, nuk janë shoqëruar me ndryshimet e duhura në Rregulloren e Përgjithshme për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës të FSDKSH-së, ku të reflektohet përshkrimi i punës dhe i detyrave kryesore që mbulon, për çdo strukturë të re që krijohet.

- Në Rregulloren e Përgjithshme për Organizimin dhe Funksionimin e Fondit, për disa Drejtori, janë referuar si bazë ligjore, ligje të shfuqizuara nga Kuvendi dhe nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për MFK për çdo njësi publike në Republikën e Shqipërisë.

- Për disa drejtori dhe sektorë në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit, janë përcaktuar detyra të ngjashme, duke angazhuar një numër të pajustificuar punonjësish në raport me detyrat që mbulojnë, duke e bërë të nevojshme rishikimin e përgjithshëm të strukturës, me qëllim reduktimin e pozicioneve të tepërta, për ta bërë administratën më efektive, më efçente dhe më të përgjegjshme për detyrat që ka dhe më pak të kushtueshme për taksapaguesit shqiptarë.

- Drejtorja e Informacionit dhe Analizës Statistike, në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në këtë rregullore, nuk ka hartuar rregulloret teknike, me qëllim mirëmenaxhimin e sistemeve të informacionit dhe të dhënave si dhe up-datimet e mundshme të tyre, detyrë kjo e lënë nga KLSH me shkresën nr. 227/15, datë 30.09.2016. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit, të marrë masat e duhura për, përmirësimin e Rregullores së Përgjithshme për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës të FSDKSH-së, duke përfshirë në këtë rregullore detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për MFK, si dhe duke reflektuar detyrat funksionale të çdo strukture të re që krijohet si rezultat e ndryshimeve strukturore me vendime të KA.

Brenda datës 30.09.2018

13.2 Rekomandimi: Të rishikojë strukturën e përgjithshme të Fondit, duke reduktuar pozicionet e tepërta dhe jo efektive, me qëllim rritjen e efektivitetit ekonomik në përdorimin e fondeve publike.

Brenda datës 30.09.2018

13.3 Rekomandimi: Drejtoria e Informacionit dhe Analizës Statistike të hartojë rregulloret teknike, me qëllim mirëmenaxhimin e sistemeve të informacionit dhe të dhënave si dhe *up-datimet* e tyre.

Brenda datës 30.09.2018

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e dispozitave ligjore për ndërtimin e sistemit të pagave në FSDKSH u konstatua se, në kundërshtim me pikën 3, të nenin 20 të VKM nr. 124, datë 5.3.2014 të Statutit të Fondit, ku përcaktohet se: *“Niveli i pagave për çdo kategori nëpunësi dhe punonjësi, përcaktohet në varësi të pagës së Drejtorit të Përgjithshëm”*, janë përcaktuar kategoritë, ku si niveli më i lartë është përcaktuar kategoria III. 5, që është ajo e Zv/ Drejtorit të Përgjithshëm. Sistemi i pagave në FSDKSH, nuk është ndërtuar në përputhje me kërkesat e nenit 20, të Statutit të Fondit, pika 2, ku përcaktohet se: *“Paga përbëhet nga paga bazë, si dhe nga shtesat me karakter të përhershëm. Shtesat me karakter të përhershëm janë shtesat për funksion, kualifikimet dhe shtesat për vështirësi në punë”*, pasi në tabelën e pagave të ndërtuar nuk është përcaktuar paga bazë, shtesa për funksion, shtesa për kualifikim dhe shtesë për vështirësi në punë etj.

Jo drejt është përcaktuar vjetërsia në punë, e cila sipas kësaj rregulloreje është përcaktuar e diferencuar vetëm për Klasën e II-të (II. 1deri II. 5) për Specialistët me një shtrirje nga 0 deri 6 vjet; 6 vjet deri në 12 vjet dhe mbi 12 vjet, çka krijon padrejtësi në shpërblimin e vjetërsisë në punë. E njëjta gjë ndodh me klasat e tjera që fillojnë nga klasa II. 5 deri në klasën III. 5 për të cilat është përcaktuar vetëm kufiri minimal i vjetërsisë në punë që varion nga 5 deri në 10 vjet për klasën më të lartë. E pa përcaktuar është paga bazë, e cila duhet marrë në raport me arsimin bazë që kërkohen për secilën klasë dhe kategori dhe mbi këtë pagë të llogaritet vjetërsia në punë brenda atyre kufijve maksimal që ka caktuar Këshilli i Ministrave (2% për çdo vit pune për periudhën 0 deri 25 vjet). Bazuar në pikën 5, të nenit 19 të Ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për SDKSH në RSH”, ku përcaktohet se: “Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave” dhe sipas dispozitave të mësipërme barazohet me kategorinë I-b të lidhjes nr. 1 të VKM nr. 711, datë 27.12.2001, i ndryshuar e gjithë struktura e pagave duhej ndërtuar si ajo e Drejtorit të Përgjithshëm e cila përbëhet nga, paga e grupit, (ajo e diplomës), shtesa për vjetërsia në punë(2% mbi çdo vit pune nga 0 deri në 25 vjet), shtesa për kualifikim dhe shtesa e pozicionit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

14.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për rishikimin e sistemit të pagave, i cili duhet të ndërtohet në varësi të pagës së Drejtorit të Përgjithshëm që përfaqëson nivelin më të lartë dhe mbi këtë bazë për çdo kategori të përcaktohet paga bazë, vjetërsia në punë, si dhe shtesat me karakter të përhershëm, ku të përfshihen shtesat për funksion, shtesat për kualifikime dhe shtesat për vështirësi në punë.

Brenda datës 30.09.2018

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin, u konstatua se, për vitin 2017, Fondi me VKA Nr. 1, datë, 27.01.2017 “Për miratimin e buxhetit Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor”, ka parashikuar në total 728 punonjës, me VKA nr. 3, datë 27.01.2017 ka shtuar numrin me 27 punonjës të tjerë duke e bërë numrin përfundimtar të punonjësve në plan 755 punonjës, të ndarë 499 punonjës për Drejtorinë Rajonale, 63 punonjës për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Universitar të Fondit, 178 punonjës për Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit dhe 15 punonjës të pashpërndarë për Fondin. Pavarësisht se ky tregues nuk është realizuar në vitin e mëparshëm, përsëri Fondi ka shtuar edhe 27 punonjës të tjerë, duke e qar numrin total në 755 punonjës, çka tregon se shtesa e numrit të punonjësve ka qenë e paargumentuar me nevojat e për më tepër në mënyrë të vazhdueshme janë planifikuar pa asnjë argument 15 punonjës të pashpërndarë. Parashikimi në planin vjetor, i 15 punonjësve të pashpërndarë dhe rrija e panevojshme e numrit të punonjësve me 27 punonjës të tjerë, ka bërë që

Fondi të krijojë një rezervë të panevojshme në numrin e punonjësve prej 42 punonjësish dhe një planifikim me rezervë të fondit të pagave dhe të sigurimeve shoqërore që, llogariten mesatarisht rreth 37,572 mijë lekë lekë (894,576 paga mesatare vjetore x 42 punonjës), trajtuar edhe në drejtimin 2 për vendimmarrjet e KA-së. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

15.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit, të marrë masat e duhura organizative për disiplinimin e numrit të punonjësve në raport me nevojat që ka fondi dhe duke hequr nga plani i numrit të punonjësve “punonjësit e pashpërndarë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për hartimin e strukturës organizative u konstatua se në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit ***nuk është përcaktuar specialiteti i kërkuar*** për të gjitha postet e pune. Nga 178 punonjës që ka struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit për 23 poste pune ku duhet të punësohen 36 punonjës ose 22% e numrit total të punonjësve, nuk është përcaktuar specialiteti i kërkuar, por është përcaktuar si specialiteti i kërkuar “*Arsimi i Lartë*”, pa përcaktuar se çfarë profesioni duhet të kenë këta punonjës, ekonomist, mjek, farmacist, jurist apo ndonjë profesion tjetër duke lënë hapësirë për rekrutimin e punonjësve me specialitete jo të përshtatshme për aktivitetin që kryen Fondi. Për disa poste pune specialiteti i kërkuar nuk është përcaktuar në përputhje me kërkesat profesionale të përcaktuara në Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

16.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e duhura që, parashikimi i specialitetit dhe arsimit i kërkuar për çdo pozicion pune në strukturën organizative të Fondit të përputhet me përcaktimet e bëra në Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës së Fondit.

Brenda datës 30.09.2018

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për marrëdhëniet e punës u konstatua se, gjatë vitit 2017 janë nxjerrë 187 urdhra, nga të cilët 79 urdhra janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 108 urdhra janë nënshkruar nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm bazuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm z. E.A, nr. 31, datë 23.05.2017, “*Për delegim kompetencash*”, protokolluar në FSDKSH me nr. 2384 prot. Sipas këtij urdhri Drejtori i Përgjithshëm, **ka deleguar tek Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm zj. A.H, kompetencat e titullarit të FSDKSH, për sa i takon marrëdhëniet kontraktuale të punës**, duke përfshirë çdo aspekt procedural të parashikuar në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në këtë urdhër duke filluar nga datë 23.05.2017 e në vazhdim, janë bërë emërimet e reja në punë, ndryshimet e pozicioneve të punës, ngritjet apo uljet në detyrë, komandimet e përkohshme me apo pa afat në pozicione të caktuara si dhe për ndërprerjen e marrëdhëniet të punës, duke shpërndarë përgjegjësitë dhe duke i bërë të pa mbështetura ligjërisht urdhrat e nxjerra nga zëvendës Drejtori i Përgjithshëm. Konstatuam se **delegimi i kompetencave sipas këtij urdhri, është bërë në kundërshtim** me Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa e II, Kreu I, neni 22, pika 3, ku përcaktohet se: “*Delegimi ose zëvendësimi i kompetencave mund të bëhet nëse: a) parashikohet shprehimisht në ligj; ...*”; me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, neni 9, “*Përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit autorizues*”, pika 5, ku përcaktohet se “*Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njërive publike nuk kanë të drejtë delegimi të përgjegjësitë të përmendura në pikën 3 dhe në pikën 4 shkronjat “a”, “ç”, “dh” e “f” të këtij neni*”, germa “dh” me këtë përmbajtje, “*mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, dhe

germa “f”, e këtij neni, me këtë përmbajtje, “Ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara”, Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në R. SH”, i ndryshuar, nenit 21, ”Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm” germa “ç”, përcakton se, “Emëron dhe shkarkon personelin dhe i propozon këshillit administrativ pagat e tyre”, pasi Drejtori i Përgjithshëm ka deleguar tek zëvendës Drejtori i Përgjithshëm kompetencat e Titullarit për përgjegjësitë lidhur me marrëdhëniet kontraktore të punës, rekrutimet, ndërprerjet e marrëdhënieve të punës, emërimet e reja në detyrë, lëvizjet paralele, ngritjet në detyrë, etj. pra dispozitat ligjore këtë kompetencë e kanë parashikuar në mënyrë të qartë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

17.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH, të shfuqizojë menjëherë urdhrin nr. 31, datë 23.05.2017, “Për delegim kompetencash”, si të pabazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për emërimet e reja në punë u konstatua se për vitin 2017, nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Zv/Drejtori i Përgjithshëm, janë nxjerrë 60 urdhra për emërimet dhe marrje në punë të punonjësve. Për vitin 2017, për 21 poste pune në Drejtorinë e Përgjithshme, ku përfshihen zv. drejtorët, punonjësit e kabinetit dhe drejtorët e drejtorive dhe për 48 poste pune në Drejtorinë, Degët dhe Agjencitë Rajonale të Fondit, gjithsej për 69 poste pune, rekrutimi është bërë pa konkurrin, por nëpërmjet emërimeve nga Drejtori i Përgjithshëm, pavarësisht se sipas rregullores së përgjithshme “Për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës” të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Rajonale, për të gjitha vendet e punës për këto poste janë përcaktuar kritere për kualifikimet, aftësitë profesionale, eksperiencën në punë, njohuritë kompjuterike, etj, e për rrjedhojë e bën të domosdoshme rekrutimin e tyre nëpërmjet konkurrencës së shtypit, sekretares së drejtorit të përgjithshëm, e cila është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm.” dhe për Drejtorinë Rajonale, pika 15, ku është përcaktuar se “Rregullat e mësipërme nuk zbatohen për emërimin e drejtorëve dhe zv/drejtorëve të Drejtorive Rajonale, Kryetarëve të Degëve dhe Përgjegjësve të Agjencive, e cila është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm.”, kanë bërë që në disa raste emërimet e reja në punë të bëhen në kundërshtim me kriteret profesionale të përcaktuara në rregulloret e brendshme. Po kështu në këtë rregullore në pikën 5, të Kapitullit të I-rë, “**Punësimi**”, për Drejtorinë Qendrore dhe në pikën 5, për Drejtorinë Rajonale është hequr detyrimi i publikimit të vendeve të lira në Buletinin e APP dhe është zëvendësuar me detyrimin e publikimit në faqen zyrtare të Fondit, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 19, “Marrëdhëniet juridike të punës” të Statutit të Fondit ku përcaktohet se: “Rregullorja e Personelit përcakton rregulla të hollësishme të emërimit të personelit, duke u bazuar në parimin e konkurrencës dhe të transparencës, të ngritjes në detyrë, të lëvizjes paralele dhe transferimit,”, duke dobësuar transparencën, përjashtuar konkurrencën dhe ulur mundësinë e rekrutimit të punonjësve me aftësi të mira profesionale dhe me eksperiencën e duhur në raport me nevojat që ka institucioni. Përjashtimi i rekrutimit të këtyre posteve nga konkurrimi me rregulloren e brendshme, bie ndash me frymën e ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011, i ndryshuar, i cili në nenin 9, pika 1, ka përcaktuar se, “Drejtori i Përgjithshëm **emërohet nga KA mes jo më pak se tre kandidatave të paraqitura nga anëtarët e KA....**”. Po kështu në nenin 19, “Marrëdhëniet juridike të punës” pika 3, e Statutit të Fondit është

përcaktuar se: “Rregullorja e personelit përcakton rregulla të hollësishme të personelit, duke u bazuar në parimin e konkurrencës dhe të transparencës”. Në këtë kontekst, nuk është korrekte dhe logjike që për plotësimin e vendeve vakant në 69 poste pune në detyra drejtuese që kërkojnë kualifikime të larta, aftësi tekniko profesionale dhe eksperiencë pune në drejtim, të përjashtohen nga konkurrimi, duke e bërë emërimin e tyre subjektiv dhe të pabesueshëm. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

18.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH, bazuar në parimin e konkurrencës dhe të transparencës, të rishikojë Rregulloren e Funkcionimit të Brendshëm të Fondit, Kapitullin 3.3 “Rregullorja e Personelit” pika e I-rë, “Punësimi”, duke shfuqizuar pikën I/14, për Drejtorinë Qendrore dhe pikën I/15, për Drejtorinë Rajonale, me qëllim që emërimet e reja në detyra drejtuese për të gjitha postet e punës, si ngritja në detyrë dhe lëvizjet paralele të bëhen nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe transparent, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit publik .

Brenda datës 30.09.2018

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për periudhën objekt auditimi nga Fondi, janë nxjerrë 51 urdhra për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, nga të cilët në 36 raste largimi nga puna është bërë me kërkesën e punonjësve dhe në 15 raste për shkelje të rënda të disiplinës në punë për mosrealizimin dhe moskryerjen e detyrave funksionale, si dhe për gjetjet në raportet e Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi u konstatuan mangësi në plotësimin e disa urdhrave të nxjerrë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, të cilët janë edhe dokumenti që përcakton zgjidhjen e kontratës së punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, pasi në këta urdhra është cilësuar se: “*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë*”, pra në të njëjtën datë kur është lëshuar, pa i dhënë mundësi punonjësit për t’u ankuar, në kundërshtim kërkesat e nenit 144, të Kodit të Punës. Mosrespektimi i procedurave standarde për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është bërë shkak që punëmarrësit të ankohen në gjykatë dhe të kërkojnë nga Fondi dëmshpërblimet e përcaktuara në Kodin e Punës, që minimalisht janë sa paga e 2 muajve, plus shpërblimin sa paga e 15 ditëve mbi çdo vite pune të plotë, ndërkohë që kur kontrata konsiderohet e zgjidhur pa shkaqe të arsyeshme, punëdhënësi detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në 1 vit pagë, që u shtohet shpërblimeve të tjera. Nga përlllogaritjet e bëra për 11 raste të analizuar dëmshpërblimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mund të arrijnë deri në 24,547 mijë lekë.

Fakti që për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në disa raste (Nr. 165, datë 18.09.2017, nr. 166, datë 18.09.2017, nr. 168, datë 18.09.2017, nr. 202, datë 03.10.2017, nr. 250, datë 16.10.2017, nr. 251, datë 16.10.2017), janë zbatuar rregullat dhe afatet e përcaktuara në kodin e punës lidhur me të drejtën e punëmarrësit për tu ankuar, ***ndërsa në urdhrat e tjerë nuk janë zbatuar këto rregulla, tregon se punohet me dy standarde për punonjës të caktuar***, çka ngarkon me përgjegjësi titullarin e institucionit. Në të gjitha rastet kur punonjësit ftohen në takimin e bashkëbisedimit, pasi dëgjohen nga grupi i punës, ky i fundit duhet t’i paraqesë propozimin përkatës titullarit, i cili vendos për masën që do të marrë ndaj punëmarrësit dhe mbi këtë bazë duhet të dalë urdhri i titullarit për masën e dhënë, e cila pasi t’i komunikohet punëmarrësit, t’i lihet koha e nevojshme e përcaktuar në kodin e punës për t’u ankuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

19.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të përcaktojë rregulla të qarta për disiplinën në punë dhe procedurat disiplinore që lidhen me marrëdhëniet e punës, si dhe të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Punës dhe me kontratën individuale të lidhur me punëmarrësit, të cilat kanë shkaktuar apo mund të shkaktojnë efekte negative për buxhetin e shtetit.

Brenda datës 30.09.2018

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për menaxhimin e burimeve njerëzore u konstatua se, nga 159 punonjës në fakt, që kanë punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit, në fund të vitit 2017 është bërë vlerësimi për 155 punonjës, nga të cilët 114 ose 74% e tyre janë vlerësuar nga eprorët e tyre me nivelin “1” shumë mirë dhe 21 punonjës ose 28% e tyre janë vlerësuar me nivelin “2” mire, çka tregon se vlerësimi ka qenë jo real dhe në përputhje me performancën që paraqet realizimi i detyrave dhe objektivave që kanë strukturat që përfaqësojnë. Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë se nga 654 punonjës gjithsej që ka Fondi, 43 punonjës ose 7% janë në pozicione drejtues (DP, Zv/DP, Këshilltar, D/Drejtorie, Dr. dhe Zv/Dr/DRF), 88 punonjës ose 13% janë në pozicion P/Spektori dhe 523 punonjës ose 80% janë në pozicionin e specialistit.

Të analizuar sipas profesioneve, 246 punonjës ose 37% janë ekonomist, 58 punonjës ose 9% janë jurist, 138 punonjës ose 21% janë mjek dhe farmacist, 63 punonjës ose 10% janë të profesioneve të tjera dhe 149 punonjës ose 23% janë punonjës me arsim të mesëm. Për vitin 2017, janë përgatitur e zhvilluar 7 tema trajnimit nga ASPA dhe DPA, por ***nuk janë përgatitur e realizuar*** nga Fondi, temat e parashikuara për implementimin e recetës elektronike dhe për menaxhimin e aktiveve dhe riskut. Nga të dhënat që paraqet Sektori i Trajnimit rezultojnë se janë trajnuar gjithsej 8 punonjës nga të cilët 5 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme dhe 3 punonjës të Drejtorive Rajonale. Të dhënat që paraqiten më sipër tregojnë se është e papranueshme dhe e pajustificuar për Fondin, mos organizimi i trajnimeve për punonjësit e veçanërisht për punonjësit e rinj që kanë filluar punë rishtas në qendër dhe në rajone, pasi i ka të gjitha kapacitetet profesionale për t'i organizuar trajnimet me shpenzime fare të vogla. Asnjë nga Drejtoritë e Fondit në qendër dhe në rajone, nuk ka plan vjetor për trajnimet dhe nuk ka organizuar temë trajnimit për ngritjen profesionale të punonjësit. Mos organizimi dhe moskryerja e trajnimeve dhe mbajtja e një sektori për këtë qëllim ka bërë Fondi të shpenzojë pa efektivitet për vitin 2017 vetëm për paga dhe sigurime shoqërore në shumën ***3,764 mijë lekë***. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

20.1 Rekomandimi: Me qëllim rritjen e aftësive profesionale të punonjësve, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e menjëhershme për organizimin e trajnimit profesional të punonjësve për çdo Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit dhe për çdo Drejtor apo Degë Rajonale.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Totali i operacioneve të vitit ushtrimor 2017, për Drejtorinë Qendrore, paraqitet me vlerën 22,918,356,769 lekë. Të ardhurat total nga operacionet e Fondit, kapin vlerën totale 20,892,253,734 lekë. Nga diferenca e totalit të të ardhurave me shpenzimet e vitit ushtrimor rezultojnë se, shpenzimet e Fondit për vitin 2017 tejkalojnë të ardhurat me vlerën **1,864,845,820 lekë**, dhe **1,995,984,980 lekë** total për FSDKSH, diferencë e pakuptimtë për një njësi publike që nuk kryen aktivitet ekonomik. Sipas Udhëzimit 14, të viti 2006... “Rezultati i Ushtrimit, saldo debitore përfaqëson tepricën debitore të llogarisë 85 "Rezultat i ushtrimit" (humbje nga viti ushtrimor). *Shkaqet e kësaj humbjeje të shpjegohen në relacionet që shoqërojnë llogarinë ... pasi për institucionet që nuk kryejnë aktivitet ekonomik nuk ka kuptim humbja*”.

Ndërkohë në shënime shpjeguese të Fondit ndodhet vetëm shënimi: “...llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” (Tepicë Debitore në shumën 1,864,845,819.69 lekë, që është rezultat negativ i FSDKSH - Drejtoria Qendrore”, ndërsa tek analiza e bilancit të konsoliduar...“Të ardhurat nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve të parësorit u transferuan 1.7 miliardë lekë më pak nga programi, gjë që ndikoi në rezultatin financiar negativ. Ky është viti i parë në të cilin FSDKSH paraqitet me rezultat financiar negativ. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 160-199 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

21.1 Rekomandimi: FSDKSH t'i kushtojë rëndësi shpjegimit të rezultatit ushtrimor si element i rëndësishëm, i lidhur drejtpërdrejt me vlerësimin e rezultateve të njësisë ekonomike, me qëllim që t'u japë përdoruesve të ndryshëm një informacion të mjaftueshëm për të ardhurat e shpenzimet që kanë marrë pjesë në formimin e rezultatit të njësisë ekonomike.

Në vijimësi

C.I MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, VKM nr. 380, datë 25.05.2016 "Për miratimin e listës së barnave që rimburohen nga FSDKSH" i ndryshuar në pikën 7 të tij, përcakton se, nëse gjatë periudhës kur ky vendim është në fuqi, ulen çmimet për barnat e paregjistruara të listës ose barnat alternativë e vetme që tregtohen në farmacitë e spitalit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me njoftim të Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, reflekton uljen e çmimit të barit në listë. Fondi ka miratuar listën e barnave të rimbursueshme për vitin 2017 dhe e ka dërguar këtë listë në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim në Këshillin e Ministrave. Megjithëse LBR-ja e vitit 2017 nuk është miratuar gjatë vitit, për arsye të cilat nuk varen prej Fondit, çmimet e reja duhet të ishin reflektuar rregullisht prej tij, sipas përcaktimit ligjor në pikën nr.7 të VKM nr. 380 pasi Fondi është pjesë e Komisionit të Çmimit të Barnave. Mosreflektimi i çmimeve të reja ka sjellë si pasojë kosto shtesë në buxhet, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në shumën **132,465,251 lekë.** *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi:FSDKSH-ja, të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm ligjorë dhe administrativë për rikuperimin e dëmit të shkaktuar në buxhetin e shtetit në shumën 132,465,251 lekë.

1.2 Rekomandimi: FSDKSH-ja së bashku me Agjencinë e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Ministrinë e Shëndetësisë, të marrin masat e duhura dhe të nxjerrin përgjegjësitë konkrete për kostot shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit, që rrjedhin nga mungesa e koordinimit midis këtyre institucioneve pjesëmarrëse në procedurën e përcaktimit dhe njoftimit zyrtar të çmimeve të barnave të rimbursueshme brenda afateve ligjore, dhe parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së auditimit në DSHSUKS, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të bankës për periudhën Korrik 2015- Korrik 2017, rezultoi se:

- DAB nuk ka rekomanduar masën e zhdëmtimit për sa janë likuiduar për shërbim dialize "Spitali A...", "Spitali H...", ku në bazë të kontratës për periudhën rezultoi se ka pacientë që kanë përfutur shërbim dializë me më shumë se 13 seanca/pacienti në muaj, spitali A.... në 1,852 seanca dhe spitali H.... në 193 seanca, ose në total 2,045 seanca, për të cilat Protokollit i dializës nuk përcakton saktë se sa seanca duhet të bëjë një pacient në javë. Nga gjetja nr. 17 e raportit të kontrollit në DSHSUKS, për përmirësimin e punës nga DAB është rekomanduar të kërkohet me shkresa zyrtare pranë Drejtorisë Spitalore në Fond, përmirësimi i protokollit të dializës, me qëllim përcaktimin e saktë të seancave që duhet të kryejë një pacientë, ndërkohë që përcaktimi i pasaktë i seancave ka sjellë efektin e shlyerjes së pajustificuar të 2,045 seancave të dializës, me efekt ekonomik në buxhet sipas çmimit për seancë në VKM nr. 308, datë 21.05.2014, i ndryshuar minimalisht në shumën **22,912,180 lekë,** vlerë për të cilën duhet të rekomandohej zhdëmtimi i saj por që mungon në rekomandimet e DAB.

- Prej Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në FSDKSH janë konstatuar 7 urdhër shpenzime, prej të cilave kanë përfutur padrejtësisht 6 subjekte, në shumën **540,876 lekë,** konkretisht, nr. 273, datë 07.12.2015, nr/274, datë 07.12.2015, nr. 20, datë 16.02.2016, nr. 26, datë 17.02.2016, nr. 95, datë 23.05.2016, nr. 118, datë 13.06.2016, nr. 113, datë 13.06.2016, dhe vlerat,

për shumën 100,000 lekë, blerje ushqimesh xhiruar më shumë subjektit “Q.....” Peshkopi, për shumën 216,249 lekë, xhiruar më shumë subjektit “A.....” Peshkopi, për shumën 5,407 lekë, likuiduar më shumë subjektit “C.....” SH.P.K.Tiranë, për shumën 50,000 lekë, blerje ushqimesh xhiruar më shumë subjektit “M.....” Peshkopi, për shumën 59,100 lekë, blerje ushqimesh, xhiruar më shumë subjektit “M.....” Peshkopi, për shumën 94,500 lekë, blerje ushqimesh xhiruar më shumë subjektit “Q.....” Peshkopi, për shumën 14,720 lekë, blerje ushqime xhiruar më shumë subjektit “A.....” Peshkopi, veprim që ngarkon me përgjegjësi administrative dhe materiale Shefin e Financës, në bazë të rregullores funksionale të funksionimit të Spitalëve, ku përcaktohen qartë detyrat e çdo punonjës, si dhe kontratave dy palëshe Spital/Fond. Për këtë, DAB ka rekomanduar se, në rastet kur konstatohen shkelje të akteve ligjore e nënligjore të rekomandohen masa mbi bazën e shkeljeve të konstatuara, duke kërkuar zhdëmtim nga punonjësit që e kanë shkaktuar dëmin dhe në rastet e konstatimit të parregullsive të kësaj natyre të kontrollohet e gjithë periudha që përfshin kontrollin, ndërkohë që DAB duhet të rekomandonte edhe masën e zhdëmtimit, e cila mungon për këtë rast, në vlerën 540,876 lekë, në funksion të dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 206-237 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e DAB të FSDKSH, të përcaktohet saktësisht vlera e 1,852 seancave dialize, të përfutur nga pacientë në “Spitalin A.....” dhe 193 seanca në “Spitalin H.....”, pra 2,045 seanca në total, si dhe të kërkohej rruga ligjore për arkëtimin e vlerës monetare të tyre, të cilat minimalisht kapin vlerën prej 22,912,180 lekë, si dhe shumën 540,876 lekë për 6 subjektet e cituara më sipër, të cilat kanë përfutur padrejtësisht nga fondet publike, kjo në funksion të zbatimit të përgjegjësisë së auditimit të brendshëm për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe ndikimin në uljen e mundësisë të përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në listën LBR 2016, e cila ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2017, për barnat spitalore bari alternativë e parë me kod 123/96 *Somatropine 5 mg (15 Nj.N)* e firmës P.... ka çmim total 12,830.5 lekë dhe vlerë që rimbursohet nga Fondi 12,189 lekë. Ky bar ka si alternativë zëvendësuese barin me kod 123/93 *Somatropine 5 mg (15 Nj.N)* i kompanisë N....., me çmim total 14,409.5 lekë dhe çmim rimbursimi 12,189 lekë. Nga krahasimi i këtyre dy alternativave zëvendësuese në LBR me të dhënat në regjistrin e barnave u konstatua se formë/dozat e paraqitura në regjistrin e barnave për këto barna janë të ndryshme, ku formë/doza 5.3 mg/1ml me kod 123/96 e firmës P..... është paraqitur në Listën e Barnave të rimbursueshme si formëdozë 5 mg/1ml, duke u renditur padrejtësisht si alternativë e parë në listë, megjithëse nuk duhet të ishte renditur e tillë. Rimbursimi i realizuar prej Fondit, duke paguar një formë/dozë prej 5.3 mg/1 ml si 5 mg/1ml, jo vetëm ka keq klasifikuar grupimin e barit, por ka sjellë si pasojë pagesa të tepërta për 0.3 g/1ml për çdo njësi të likuiduar, pasi formë/doza që mbulohet nga Fondi është vetëm 5mg/1ml. Sasia e rimbursuar për Barin me kod 123/96 e firmës P..... dhe formë/dozën reale 5,3 mg/1ml është 734 njësi, në vlerën 9,417,587 lekë. Efekti financiar i paguar padrejtësisht nga Fondi, si rrjedhojë e përcaktimit të gabuar të formë/dozës për vitin 2017 dhe grupimi i gabuar i tyre llogaritet në 533,071 lekë. Ky efekt për vitin 2016 mbi bazën e konsumeve të disponuara për një sasi prej 402 barnash, të rimbursuar me vlerë 5,157,861 lekë, llogaritet në shumën 291,954 lekë dhe në total për vitet 2016 dhe 2017, duke qenë se lista e barnave nuk ka ndryshuar, pagesat e realizuara në tejkalim të vlerës së mbuluar nga Fondi janë 825,025 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin e vlerës së paguar padrejtësisht nga ana e Fondit për barin Somatropine me emër tregtar Genotropin Go Quick e firmës P... me kod 123/96 dhe formë/dozë faktike 5,3 mg/1ml, për shumën 825, 025 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të realizimit të kontratave u konstatua vonesë në lëvrimin e mallrave të prokuruar prej operatorit A.....shpk. Kontrata nr. 8/7 prot. me këtë operator është lidhur më datë 30.06.2017. Sipas Nenit 10 Penalitetet “nëse shkelet afati i lëvrimit nga Kontraktuesi, ky i fundit duhet t’i paguajë për çdo ditë vonesë kamatë në masë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por jo më pak se 25% të vlerës së saj”. Grupi i punës së marrjes në dorëzim, ngritur me urdhrin e DP me nr. 118, datë 20.07.2017, në datën 20.07.2017 ka konstatuar se në shtypshkrimet e sjella nuk respektoheshin disa nga specifikimet teknike, si rezultat është mbajtur procesverbal dhe është njoftuar kontraktuesi për mos përmbushje të kontratës. Nga likuidimet e bëra në drejtim të këtij operatori u konstatua mbajtja e një penaliteti me vlerë 71,536 lekë për 15 ditë pune vonesë, jo kalendarike, si dhe nuk është zbatuar vlera e penalitetit në masën 25% e vlerës së kontratës prej 298,065 lekë (1,192,260 me tvsh*25%), duke bërë që shuma 226,529 lekë të mos jetë arkëtuar konform zbatimit të kushteve të penalitetit të kontratës. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 160-199 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandimi: Të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin e penalitetit mbajtur më pak operatorit A.....në vlerën 226,529 lekë, në funksion të zbatimit të kushteve të kontratave lidhur me operatorët ekonomik.

Menjëherë

C.II MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, ndërsa planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit si për PBA dhe projektbuxhetin vjetor është bërë i ndarë sipas kategorive përfituese të rimbursimit referuar udhëzimit të FONDIT për planifikimin e treguesve buxhetorë, ato janë çelur në total, pa u ndarë në kategori, veprim në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit të FSDKSH nr. 4, datë 14.2.2017 ku përcaktohet se: “Në nivel nën artikulli dhe analize, përveç shpenzimeve për investime, detajimi do të kryhet nga Drejtoria Rajonale, apo dega dhe do të dërgohet në Drejtorinë Ekonomike në FOND, në formë elektronike dhe shkresore, brenda datës 20.02.2016”. Megjithëse çelja dhe detajimi nga DRFSDKSH në rrethe është bërë në total, Drejtori Rajonale, si Durrësi, Fieri, Elbasani dhe Lushnja, kanë bërë një detajim të saktë të rimbursimit dhe e kanë përcjellë në FOND, megjithatë nga strukturat përkatëse në FOND nuk është kërkuar nga DRF dhe Degët detajimi i shpenzimeve të rimbursimit konform udhëzimit, si dhe nxjerrja e përgjegjësive për moszbatimin e tij, duke vepruar jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, KREU II, pika 15, Udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH nr. 4, datë 14.2.2017 “Për zbatimin e buxhetit të FSDKSH për vitin 2017”, pika 3, “Detajimi i shpenzimeve”, paragrafi 2., Rregullore Financiare e FSDKSH miratuar me Vendimin e Këshillit Administrative nr. 121, datë 17.12.2014, ndryshuar me vendimin nr. 33, datë 24.07.2015, KREU III “Buxheti i FSDKSH, pika B. Nga të dhënat e vëna në dispozicion prej FSDKSH-së konstatohet se rritje të vlerës së rimbursimit në shumë absolute për 1,991,803 mijë lekë. Kjo vlerë përbën një rritje drastike prej 23.6% të shpenzimeve për rimbursimin barnave krahasuar me vitin e mëparshëm. Në kushtet e përdorimit të këtyre fondeve jo për qëllimin e parashikuar në buxhet, e shoqëruar nga ulja e numrit të përfituesve në skemë, kur çmimet e LBR-së nuk kanë pësuar ndryshime gjatë kësaj periudhe, ku numri i

recetave është rritur vetëm me 3.4% në krahasim me një vit më parë, mungesës së analizave sektoriale, si dhe në kushtet e mungesës totale të ushtrimit të kontrolleve nga strukturat e Fondit në kundërshtim me dispozitat ligjore të evidentuar gjatë këtij auditimi, tregon më së paku një keqmenaxhim të fondeve publike në vlerën **1,991,803 mijë lekë**. Kjo dukuri bëhet më e theksuar prej muajit Qershor 2017 dhe në vazhdim. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 125-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit..

1.1 Rekomandimi: Nga FSDKSH, të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e shpenzimeve të rimbursimit, analizimin e treguesve me qëllim miradministrimin e fondeve, si dhe për të shmangur tejkalim të planit të shpenzimeve, sikurse ka ndodhur përgjatë vitit 2017. Nga FSDKSH, të merren masa për rishikimin hartimin e një udhëzimi, rregulloreje apo metodike me kritere të mirë përcaktuara për kryerjen e analizave të rimbursimit, duke marrë në konsideratë dhe mënyrën e funksionimit të sistemeve informatikë.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Ministri i Financës dhe Ekonomisë të vlerësojë problematikën e ngritur më lart dhe të verë në lëvizje strukturën e Inspektimit Financiar, për të eliminuar riskun e një skemë potenciale mashtrimi financiar.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave nga dhënësit e kontraktuar nga Fondi u konstatua se:

- Mënyra e interpretimit të kontrolleve, të cilat janë bazuar në klauzolat e kontratës së re F/2016 dhe kontratës F/2015 dhe shtojcës F /2015, për periudhën të cilën kjo kontratë mbulon, grupet e kontrollit kanë pranuar që shkeljet, edhe pse i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në kontratë të mos merren parasysh për zgjidhjet e kontratave, **duke i argumentuar si shkelje të cilat i përkasin periudhës së kontratës paraardhëse**. Në bazë të kapitullit “*Detyrime specifike*” të Kontratës F/2015, pika 16, ka mundur vazhdimësinë e Kontratës F/2016 të sapolidhur dhe rrjedhimisht, rezultatet dhe sanksionet për kontrollet e kryera janë vendosur sipas kësaj kontrate duke e mbyllur të gjithë fenomenin e diferencave me disa gjoha minimale dhe me mbajtjen në muajin pasardhës të shumave të rimbursuara padrejtësisht. Në këtë mënyrë, janë mbyllur diferencat minus dhe plus në inventarët kontabël dhe nga ana e Fondit janë vendosur penalitete të papërfillshme për subjektet kundërvajtëse dhe këto subjekte kanë vazhduar të rimbursohen normalisht nga FSDKSH-ja. Për 12 farmacitë të cilat janë kontrolluar nga ana e DKPF-së gjatë vitit 2017, dhe kanë rezultuar me diferencë në **plus** dhe **minus** mbi përcaktimet e parashikuara në kontratën F/2016 dhe Shtojcën, DKP-ja nuk ka marrë masën e ndërprerjes së kontratës sipas rekomandimeve të lëna edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH-së (për vitin 2016). Mosndërprerja e kontratës dhe rimbursimi i këtyre farmacive nga ana e FSDKSH-së i bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kontraktuale të kontratës me farmacitë llogaritet kap vlerën prej **144,404 mijë lekë**.

- Me shkresën me Nr. 1821 Prot., datë 14.04.2016, të Drejtorisë Juridike të FSDKSH-së, është bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: *Kallëzim të kryerjes së veprës penale të “Mashtrimit”, “Mashtrimit në subvencione” dhe “Fallsifikim të Dokumentave Shëndetësore”*. për farmacitë “A....”, “B....”, “C....”, “E....”, “G....” dhe “N....”. Përveç përcaktimeve në Kontratën F/2015, referimi i këtyre farmacive për ndjekje penale në Prokurori duhej të ishte bërë shkak për të mos e lidhur Kontratën F/2016, e cila ka filluar zbatimin pas hyrjes në fuqi të LBR-së 2016, pra në muajin qershor të vitit 2016 ekzaktësisht dy muaj më vonë, pas kallëzimit penal të bërë për këto farmaci nga ana e FONDIT. Në kapitullin “*Kriteret*”, pika 14 e kësaj kontrate, F/2016, përcaktohet se: “*Nuk lidhet kontratë me Farmacitë të cilat janë nën hetim nga organi I akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate deri në përfundimin e*

plotë të hetimeve.”. Pavarësisht së është lidhur Kontrata F/2016, këtyre farmacive nuk u është pezulluar aktiviteti sipas klauzolës “*Pezullim Aktiviteti*” të kësaj kontrate. Kjo pikë është trajtuar nga grupi i KLSH-së gjatë auditimit të mëparshëm, por nga ana e FONDIT nuk është ndërmarrë asnjë veprim administrativ për ndërprerjen e këtyre kontratave të lidhura padrejtësisht. Rimbursimi i farmacive, të cilat janë në procedim penal nga organi i akuzës, për të cilat FSDKSH duhet të kishte marrë masën e moslidhjes së kontratës, por ka vijuar rimbursimin e tyre në kundërshtim me dispozitat e kontratës me farmacitë, për periudhën Mars-Dhjetor 2017 arrin vlerën prej **222,581 mijë lekë**.

- Grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm në faqe 114-137, të Raportit Përfundimtar ka trajtuar hollësisht auditimin e përputhshmërisë pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë sipas programit të Auditimit Nr. 1751/1 Prot datë 12.4.2016, të miratuar prej Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, për periudhën 01 Janar 2015 - 31 Mars 2016. Në vazhdimësi është konstatuar moszbatimi i masës për ***ndërprerjen e kontratave***, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Fondit Tiranë, për farmacitë që kanë shitur barna që u ka kaluar afati i skadencës e trajtuar, në faqe 8 “Rekomandimet “ Gjetja Nr. 14 të Raportit Përfundimtar të DAB-së, në DRF Tiranë. Sipas të dhënave të FONDIT rimbursimet kanë vijuar normalisht megjithëse për këto subjekte duhet të merrej masa e menjëhershme e ndërprerjes së kontratës prej periudhës Gusht 2016 deri në Dhjetor 2017. Rimbursimi për periudhën Gusht 2016-Shkurt 2017 ka qenë në shumën 205,708,709 lekë për 20 subjektet farmaceutike është trajtuar nga grupi I KLSH- së në auditimin e mëparshëm. Rekomandimi i lënë nga DAB e FSDKSH-së por dhe nga KLSH nuk ka gjetur zbatim nga Drejtoria Rajonale e Fondit Tiranë, e cila duhet të kishte ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale me këto farmaci. Për të njëjtat subjekte për periudhën Mars 2017 - Dhjetor 2017 vlera e rimbursuar padrejtësisht nga ana e FSDKSH kap vlerën **333,104 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 85-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: FSDKSH të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore të nevojshme për ndërprerjen e kontratave me subjektet e cituara më sipër, të cilët kanë rezultuar me shkelje të detyrimeve kontraktuale, **a)** për diferenca të konstatuara në plus dhe minus mbi kufijtë e përcaktuar, **b)** për subjektet me të cilat nuk duhej të ishte lidhur kontrata, si dhe **c)** për subjektet e rekomanduara nga Auditimi i Brendshëm, të cilat nuk kanë gjetur zbatim deri në përfundim të këtij Raporti Auditimi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në 30 raste Këshilli Administrativ ka miratuar me vendim, rimbursim të barnave përtej kufizimeve në përdorim, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me një vlerë rreth 139.5 milion lekë. Përkatësisht me vendimet nr.11 dhe 12, dhe vendimet 16 deri 40 të vitit 2017 janë rimbursuar barna të cilat janë të përfshira në listën e barnave të rimbursueshme në fuqi dhe si të tilla vendimmarrjet e KA-së janë të panevojshme dhe në tejkallim të kompetencave por njëkohësisht procedura e përzgjedhjes së rasteve për rimbursim nga një komision i posaçëm gjykojmë është diskriminues dhe i pambështetur në ligj. Kjo praktikë i mbivendoset paketës së listës së barnave të rimbursueshme të miratuara nga Këshilli i Ministrave duke u kthyer në një hallkë të tepërt administrative dhe duke kufizuar aksesin e popullatës në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Problematika ka vijuar gjatë muajve të parë të vitit 2017 dhe më pas është ndërprerë si rezultat i konkluzioneve të dala në auditimin e mëparshëm të KLSH, por konstatojmë që akti administrativ VKA nr.70, datë 18.04.2014 nuk rezulton ende i shfuqizuar. Konstatohet se për 30 rastet e shqyrtuara nga KA-ja gjatë vitit 2017 janë tejkalluar kompetencat e parashikuara në përdorimin e barnave në shumën **139,490 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ të shfuqizojë VKA nr.70 datë 18.04.2014 i cili i mbivendoset padrejtësisht listës së barnave të rimbursueshme duke lejuar aksesin e barabartë në këtë skemë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në kontrollet e kryera nga DKPF-ja, janë konstatuar diferenca inventarësh *në minus*, (gjendja fizike e mallrave barnave është më e vogël se gjendja kontabël), në shumën 47,059,903 lekë të padeklaruara nga shitja e mallrave (barnave), të cilat janë përkatësisht 17,617,641 lekë për Kontratën dhe Shtojcën F/2015 dhe 29.442.262 lekë për Kontratën F/2016. Gjithashtu, janë konstatuar edhe diferenca *në plus*, (gjendja fizike e mallrave barnave është më e madhe se gjendja kontabël), në shumën 6,071,878 lekë, për të cilat nuk është përcaktuar origjina e këtyre tepricave. Në dosjet e kontrolluara, nuk ka asnjë dokumentacion në të cilin të shpjegohet, të arsyetohet dhe të dokumentohet origjina e tepricave. Grupet e kontrollit, *nuk e kanë evidentuar burimin e tepricave të pajustificuara me dokumentacionin* që përbën provë ligjore. Prej tyre është pranuar rregullisht, se këto barna janë pjesë e LBR-së 2016, nga depot farmaceutike kanë hyrë në formë të rregullt në farmaci, të shoqëruara me dokumentacionin tatimor përkatës, pra është pranuar në heshtje se këto teprica janë shkaktuar si rezultat veprimeve të parregullta të bëra me daljet (shitjet e tyre). Për të dyja llojet e diferencave në inventarë, nuk janë njoftuar organet tatimore, sipas kontratës. Mosnjoftimi i organeve tatimore një veprim i përsëritur ky nga Fondi dhe i rikonstatuar nga grupi i KLSH-së për diferencat *në minus*, ka bërë që Farmacitë të krijojnë shmangie të detyrimeve tatimore. Në bazë të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, (i ndryshuar), vlera e shitjeve të padeklaruara sjell shmangie të tatimit mbi fitimin, në masën 15% të vlerës së padekluar të shitjes së mallrave (barnave). Diferencat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera përbëjnë vlerë të pallogaritur dhe të paarkëtuar në Buxhetin e Shtetit. Vlera e shmangies gjithsej për diferencat *në plus* dhe *minus* arrin në **13,158 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 85-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandimi: FSDKSH-ja të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve një informacion të plotë të gjithë subjekteve farmaceutike të evidentuara me diferenca në inventarë nga DKPF-ja, listuar në Tabelën 3.9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, me të gjitha të dhënat individuale të farmacive të konstatuara si NIPT, administrator, adresë, kopje të dokumentacionit të kontrollit, ku janë evidentuar diferencat inventariale, për ndjekje të mëtejshme nga ky organ.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se FSDKSH mban fondin rezervë me vlerë 3,624,400,000 lekë, i cili në zbatim të Nenit 24, Pika 1, gërma “b” e Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Statutin e Fondit miratuar me VKM Nr. 124, datë 5.3.2014 “Për miratimin e statutit të Fondit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 23, Pika 2 “Fondi rezervë i sigurimeve të detyrueshme përbëhet nga tepricat e akumulueshme të të ardhurave ndaj shpenzimeve. Fondi rezervë është një fond emergjence për mbulimin e lëvizjeve të përkohshme dhe të deficiteve operative në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me rregullat e përcaktuara për këtë qëllim me vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi rezervë nuk duhet të kalojë 10 për qind të shpenzimeve vjetore të Fondit” mbahet si tepricë e akumulueshme e të ardhurave ndaj shpenzimeve për tu përdorur për rastet e financimit të shpenzimeve dhe deficiteve të përkohshme operative, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. (Shpenzimet vjetore për gjithë FSDKSH kanë kapur vlerën 39,449,518,670 lekë dhe deficitin 1,995,984,980 lekë).

Gjatë vitit 2017 *nuk është riinvestuar fondi rezervë në bono thesari, megjithë maturimin e tij nga investimi i kaluar, duke sjellë një të ardhur të munguar për Fondin.* Në datën 21.09.2017 është maturuar investimi i FSDKSH në bono thesari i vlerës 1,5 miliardë lekë nga llogaria e Fondit Rezervë, sipas ankandit nr. 1765, datë emetimi 22.09.2016, në të cilën interesi i fituar i arkëtuar në momentin e emetimit ishte 20,024,593 lekë. Pas këtij maturimi fondi rezervë arrinte në vlerën 3,624,400,000 lekë, shifër e miratuar me VKA nr. 57, datë 17.07.2017 “Për miratimin e rezultatit financiar të FSDKSH për vitin 2016”. Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë interesi mesatar në ankandin e datës 05.09.2017 me maturim 12 mujor ka qenë 2.29%. Nëse do të investohej vetëm shuma 3,400,000,000 lekë, *interesi i pritshëm do të ishte afërsisht 75,709 mijë lekë.* Sipas VKM nr. 305, datë 20.4.2016 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 23, Pika 5 e tij, “Drejtori i përgjithshëm, me miratimin e Këshillit Administrativ, investon në letra me vlerë të qeverisë shqiptare deri në 100 për qind të fondit rezervë. Interesat e lidhura me investimin e fondit rezervë transferohen në llogaritë e Fondit”. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 160-199 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1 Rekomandimi: FSDKSH të marrë masa për rritjen e efijencës dhe efektivitetit të menaxhimit të likuiditeteve në dispozicion, duke vlerësuar dhe zbatuar mundësitë për plotësimin e nevojave të Fondit edhe me të ardhura të realizuara nga përdorimi i burimeve të veta.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Me VKA nr. 68, datë 19.12.2017, KA-ja ka vendosur që marzhi i fitimit midis vlerës së paketës nga shërbimet spitalore publike, për vitin 2017 dhe kostos, i përcaktuar me VKM për secilën paketë i llogaritur për tu financuar këto institucione ofruese të shërbimit të paketave të përdoret a) *për shpërblim deri dy paga mujore për punonjësit e shërbimit që ofron paketat dhe b) për shpenzime për mallra dhe shërbime.* Po kështu, me vendimin nr. 72, datë 29.12.2017 “Për shpërblimin e punonjësve të Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza”, KA-ja ka vendosur shpërblimin deri në një pagë mujore për punonjësit e disa shërbimeve të veçuara në këtë spital. Për sa më sipër vendimmarrjet e KA-së me vendimet nr. 68, datë 19.12.2017 dhe nr. 72 datë 29.12.2017 për shpërblimet e punonjësve të shërbimeve që ofrojnë paketat e shërbimeve shëndetësore bie në kundërshtim me pikën 6, të Vendimit nr. 18, datë 11.01.2017 të KM, “Për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore nga Skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2017” dhe VKM Nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, ndryshuar me VKM nr. 818, datë 29.12.2017, duke sjellë efekte negative në buxhetin e shtetit, në shumën totale të shpërblimeve që mund të shkojë deri në nivelin e marzhit të akumuluar prej këtyre institucioneve për vitin 2017, i cili kap vlerën 80,600 mijë lekë. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ të ndërpresë caktimin e shpërblimeve për punonjësit e institucioneve ofruese të paketave shëndetësore, nga marzhet e akumuluar të fitimit të pambështetur në dispozita ligjore.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 141, datë 24.08.2017, është krijuar Grupi i punës për rishikimin e strukturës së Fondit. Grupi i punës me Memo nr. 4592/1, datë 22.09.2017, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ka paraqitur propozimet përkatëse për ndryshimin e strukturës dhe organikës aktuale të Fondit. Këshilli Administrativ me vendimi Nr. 63, datë 25.09.2017 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të FSDKSH-së dhe disa ndryshime në organizimin e zyrave vendore të Fondit”, ka miratuar ***pakësimin e numrit total të punonjësve për 163 punonjës,*** duke e reduktuar numrin e përgjithshëm të

punonjësve në 592 punonjës nga 755 të planifikuar. Për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës 4, është ngarkuar Drejtori i Përgjithshëm. Në pikën 5 të këtij vendimi është përcaktuar se: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa efektet financiare të tij fillojnë me miratimin e strukturës në përputhje me legjislacioni në fuqi”, në kundërshtim me pikën 4 të Projektvendimit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, ku përcaktohej se: “4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”. Ky përcaktim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Pjesa e V, Kreu I, neni 99, pika 2, ku përcaktohet se: “Akti administrativ i shkruar në letër përmban: germa i), dispozitën që tregon: ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;”, duke bërë që Fondi të vazhdojë punën me strukturën e mëparshme, e për rrjedhojë për periudhën 01.10.2017 deri më 31.12.2017 ka mbajtur 163 punonjës më tepër, me një efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit në shumën **36,454 mijë lekë** (Paga mesatare mujore 74,548 x 3 muaj x 163 punonjës), efekt negativ që vazhdon të rritet përgjatë vitit 2018 deri në miratimin e strukturës së re. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për efektet negative financiare të shkaktuara për buxhetin e shtetit nga mbajtja e 163 punonjës më tepër për periudhën 01.10.2017 deri më 31.12.2017.

Brenda datës 30.09.2018

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se FSDKSH-ja ka kallëzuar penalisht për veprat penale të “Mashttrimit”, “Mashttrimit në subvencione” dhe “Falsifikim të Dokumenteve Shëndetësore” për përfitim të padrejtë të rimbursimit me kontratën F/2015 dhe shtojcën, të produkteve farmaceutik “suplemente” të cilat nuk evidentohen si barna subjekte me të cilat ka rilidhur kontratë të re F/2016, duke vazhduar rimbursimet dhe gjatë vitit 2017. DRF Tiranë, e cila duhet të kishte marrë masën e moslidhjes së kontratës /pezullimit, ka vijuar rimbursimin në kundërshtim me dispozitat e kontratës me farmacitë në shumën prej 222,581,407 lekë, për periudhën Mars-Dhjetor 2017.

Është konstatuar moszbatimi i masës për ndërprerjen e kontratave nga ana e Drejtorisë Rajonale të Fondit Tiranë, për farmacitë që kanë shitur barna që u ka kaluar afati i skadencës, rekomandim I DAB-së, në Raportin Përfundimtar në DRF Tiranë. Sipas të dhënave të FONDIT rimbursimet kanë vijuar normalisht, megjithëse për këto subjekte duhet të merrej masa e menjëhershme e ndërprerjes së kontratës prej periudhës Gusht 2016 deri në dhjetor 2017. Për 20 subjekte, ky rimbursim për periudhën Mars 2017-Dhjetor 2017 ka vlerën 333,104,466 lekë.

Nga ana e DRF Tiranë janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna nga DAB, për masën e zhdëmtimit të rekomanduar për 50 subjekte farmaceutike me shkresën e Fondit (Drejtoria e Auditit të Brendshëm) nr. 1134 prot, datë 06.03.2017, protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tiranë, me nr.1520 prot, datë 08.03.2017. Shuma e urdhër zhdëmtimeve nga DRF Tiranë është **16,400 mijë lekë**, ndërkohë që nuk asnjë shpjegim për këtë deviacion, pasi rekomandimi i DAB-se, konfirmuar edhe nga grupi i KLSH-së në auditimin e mëparshëm ka qenë për shumën **44,100 mijë lekë**. Pra efektivisht rezulton një vlerë prej e munguar në Buxhetin e Shtetit për shumën **34.153 mijë lekë**. Për ecurinë e urdhër zhdëmtimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm është kërkuar të raportohet zyrtarisht në Fond (Drejtorinë e Auditit të Brendshëm) çdo muaj deri në realizimin përfundimtar të tyre. Ky raportim nuk është bërë nga ana e DRF Tiranë në vazhdimësi dhe periodikisht, sikurse është lënë detyrë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 206-237 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: FSDKSH të verifikojë procedurat dhe veprimet e kryera nga ana e DRF-Tiranë për ndërprerjen e kontratave me farmacitë, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të DAB,

arkëtimin e masave zhdëmtuese të munguara në shumën **34.153 mijë lekë** dhe zbatimin në kohë dhe me efikasitet të rekomandimeve të lëna nga DAB.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimin për mirëmbajtjen e sistemit BI, “Sistemi për integrimin, konsolidimin, monitorimin e informacionit të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe ndërtimi i indikatorëve dhe analizave (BI)” të parashikuar në kontratën nr. 13/11, datë 23.09.2016, me objekt “*Marrëveshje në nivel shërbimi (MNSH/Suport) për sistemet informatike të FONDIT*”, për periudhën dy vjeçare në shumën 8,600 mijë lekë, u konstatua se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga DIAS, fillimisht në këtë sistem kanë patur akses 41 punonjës të FSDKSH, **aktualisht në këtë sistem janë aktiv vetëm 4 përdorues**, ndërsa për 37 përdorues akses i është inaktiv, pra akses i informacionit që do të gjeneronte ky sistem për treguesit në lidhje me skemën shëndetësore **është përqendruar vetëm në katër punonjës** dhe këta punonjës të DIAS, duke mos patur akses në mënyrë të pakuptimtë drejtoritë teknike.(Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, si dhe Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik), të cilët analizojnë treguesit dhe kryejnë kontrollet.

Në të dhënat e kontratës së mirëmbajtjes përshkruhet se: “*Në këtë sistem janë ndërtuar dhe janë funksionale 110 raporte dhe janë në përdorim nga punonjësit e Fondit. Informacioni përkatës paraqitet në nivel të përmbledhur dhe në nivel të detajuar sipas nevojave të përdoruesit. Platforma softëare paraqet burimet e të dhënave dhe raportet, analizat, indikatorët në një strukturë logjike të orientuara nga dhe të kuptueshme sipas rregullave të biznesit të institucionit. Sistemi bën konsolidimin e të dhënave të që ruhen në sistemet e ndryshme ekzistuese që operojnë sot në FSDKSH, në një bazë të dhënash të integruar, si pjesë integrale e sistemit të statistikave dhe raporteve analitike*”.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion deri në 30.03.2018 nga DIAS, kryesisht për treguesin e rimbursimit të barnave konstatohet se burimi i të dhënave është a) nga sistemi offline që administrohet nga FONDI dhe b) nga sistemi eRx që administrohet nga kompania implementuese e recetës elektronike eRx “I.....”.

Për sa më sipër konstatohet se, të dhënat jepen të ndara për të dy sistemet, pasi nga muaji Maj 2017 e deri në kohën e përfundimit të auditimit, ky sistem nuk bën konsolidimin në kohë reale të të dhënave të sistemit eRx (sistemi i recetës elektronike), ndërkohë që në **raportet e mujore të kryerjes së shërbimit** evidentohet se, BOE “S.....” shpk dhe “F.....” shpk, ka kryer çdo muaj në mënyrë periodike:

-Suport- kontroll i logeve të sistemeve,

-Kontroll i statistikave të storage (Used disk space ect) në serverat ku është instaluar sistemi objekt i mirëmbajtjes,

-Kontroll i statistikave për programet software objekt i mirëmbajtjes,

-Mirëmbajtje proaktive.

Si përfundim, nga grupi i ngarkuar me ndjekjen dhe monitorimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor, i përbërë nga E.K., D.M dhe përfaqësuesi i DSHMA F.S, janë nënshkruar raportet mujore, pa bërë asnjë reklamim të nivelit të shërbimit dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit, i përbërë nga L.O, I.Ç dhe J.I, është bërë marrja në dorëzim e shërbimit pa vërejtje, e për rrjedhojë nuk vërtetohet marrja e shërbimit në nivelin e duhur nga kompania kontraktuese e shërbimit si dhe nëse shërbimet informatike justifikojnë kostot e tyre. Nga ana tjetër mirëmbajtja e sistemit BI nga BOE “S....” shpk dhe “F.....” shpk, nuk është realizuar në mënyrë efektive dhe në formën e duhur për të ofruar shërbimin e nevojshëm për një periudhë një vjeçare, duke bërë që fondet buxhetore në shumën **4,300 mijë lekë të përdoren pa efikasitetin dhe efektivitetin e duhur**. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 238-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit dhe DIAS të verifikojnë dhe analizojnë me përgjegjësi realizimin e shërbimit për mirëmbajtjen e sistemit BI nga BOE “S.....” shpk dhe “F.....” shpk në zbatim të kontratës nr. 13/11, datë 23.09.2016, me objekt “Marrëveshje në nivel shërbimi (MNSH/Suport) për sistemet informatike të FONDIT” dhe në përfundim të verifikimit, nëse rezultojnë shërbime të pakryera t’i zbriten nga likuidimi i faturës.

Brenda datës 30.09.2018

9.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit dhe DIAS të verifikojnë funksionimin e të gjitha sistemeve informatike sipas kushteve teknike, të evidentojë dhe zgjidhë problematikat në funksionimin e tyre. Të informohet Këshilli Administrativ lidhur me konkluzionet përkatëse.

Brenda datës 30.09.2018

9.3 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të marrë masat e nevojshme për aksesimin në këtë sistem jo vetëm drejtuesve të lartë të Fondit por edhe të gjithë punonjësve të cilët nevojitet të përdorin këtë informacion në përputhje me detyrat e tyre funksionale.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 41, datë 21.03.2017 Këshilli Administrativ ka miratuar shpërblim me një pagë mujore anëtarët e komisioneve të rishikimit të paketave të shërbimeve shëndetësore, punonjës të Fondit, nga veprimtaria e të cilëve janë miratuar vendimet e KA-së Nr. 6, datë 27.01.2017, Nr. 93,94,95,96 datë 13.12.2016 si dhe është ngarkuar Fondin për zbatimin e tij. Megjithëse aktet ligjore kanë përcaktuar qartë kush kontraktohet dhe cilët janë anëtarët përfitues të shpërblimit nga ana tjetër veprimet e kryera në praktikë janë tërësisht të kundërta duke shpërblyer ata anëtarë për të cilët mungon një përcaktim të tillë. Punonjësit e Fondit janë pjesëmarrës në komisionet teknike mbi bazën e kësaj cilësie, shpërblimi i tyre për punën brenda orarit zyrtar të punës së tyre në gjykimin tonë përbën tejkalim të kompetencave nga ana e KA-së me ndikim negative në buxhetin e Fondit duke e shoqëruar procesin me kosto financiare shtesë të panevojshme. Po kështu likuidimi i efekteve financiare të urdhrin nr. 1434, nga Fondi i veçantë bie në kundërshtim me VKM Nr. 929 ,datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar. Efekti financiar i këtij vendimi të pambështetur ligjërisht shkon në **1,800 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

10.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ të ndërmarrë veprimet e duhura administrative dhe ligjore për përcaktimin e saktë të kriterëve dhe masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve teknike të kontraktuar prej Fondit dhe jo për punonjësit e brendshëm të institucionit, të cilët janë anëtar të këtyre komisioneve për shkak të cilësisë së tyre si punonjës të përhershëm të Fondit dhe shpërblehen për punën e kryer sipas kontratës së punës.

Brenda datës 30.09.2018

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për shkresat e dërguara nga DÇRB tek DKPF, për muajt janar-qershor 2017, për mungesat e barnave në tregun farmaceutik, të iniciuara nga QSUT, nuk ka kontrole të kryera nga sektori i Depove Farmaceutike. Pra nuk është zbatuar objekti i punës së kësaj Drejtorie që është kontrolli i zbatimit të detyrimeve kontraktuale të subjekteve të kontraktuara me Fondin dhe strukturat vartëse të saj, ku përfshihen *Qendrat Shëndetësore, Farmacitë dhe Depot Farmaceutike*. Nga DÇRB-ja nuk ka një kërkim informacioni nga DKPF, për shpjegimin e mungesave të barnave në treg, për një periudhë 5-mujore. Nga auditimi i dosjeve të kontroleve të kryera nga Sektori i Kontrollit të depove Farmaceutike sipas shkresave të ardhura nga QSUT, të cilat saktësonin mungesën e barnave specifike në rrjetin farmaceutik, rezultoi se pas kontrollit nuk është marrë asnjë masë penaliteti ndaj depove farmaceutike në lidhje me mosfurnizimin e barnave të përcaktuara në Aneksin A, në momentin e

lidhjes së Kontratës Depo Importuese-Fond. Nisur nga numri i rasteve për të cilat depot farmaceutike (6 subjekte), të konstatuara nga FONDI, me gjendje të barnave të LBR-së, në momentin e kontrollit, nuk kanë kryer furnizimin e QSUT-së dhe rrjetit farmaceutik, ndërkohë që barnat kanë qenë gjendje në magazinë sipas pikës 17, kapitulli Penalitetet, të Kontratës Importues Farmaceutik –Fond 2016, duhet të ishin penalizuar nga sektori i kontrollit. Kjo vlerë e munguar dhe penalitet i shmangur është **900 mijë lekë**. Këto veprime dhe mosveprime nga Drejtoria e Kontrollit kanë sjellë jo vetëm efekt financiar, por një mungesë të barnave në treg shoqëruar kjo me përkeqësim të shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor.

Për zbatimin e kriterëve të Kontratës Importuesi Farmaceutik/2016/ - FOND, Kapitulli “Detyrimet e Importuesit” Farmaceutik, pika 5 dhe pika 12, si dhe Kapitulli Zgjidhja e Kontratës, pika 9, u verifikuan informacionet periodike të sjella me e-mail për vitin 2017 (sipas muajve), nga ana e Depove Farmaceutike si dhe proces-verbalet e mbajtura për çdo rast nga Sektori i Analizës së informacionit pranë DIAS, për të cilat u konstatua moszbatimi nga ana e Fondit të pikave (5) dhe (12) dhe (9) të Kontratës Importuesi Farmaceutik 2016 - FOND. Nga moszbatimi dhe ndjekja periodike e kushteve të Kontratës, Importuesi Farmaceutik/2016/, nga DKPF, dhe DIAS, dy drejtoritë në Fond të cilat kanë për detyrë bashkëpunimin, kemi **shmangie të penaliteteve** në vlerën **600 mijë lekë** për 6 subjekte dhe **moszgjidhje të kontratave** për 4 (katër) depo farmaceutike. Për vitin 2017, ky informacion dhe detyrë e DIAS-it, nuk është përcjellë në DKPF në FOND. Mospërcjellja e informacionit në këtë drejtori sjell shmangie të përgjegjësisve përkatëse nga secila prej tyre, pasi nuk merren masa në kohë për raste të moszbatimit të kushteve të kontratës me depot importuese, si dhe nuk parashikohet risku që paraqet secila nga këto depo në mosdërgimin saktë të të dhënave mujore apo mosdërgim të informacionit.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes për lidhjen e kontratave me Depot Farmaceutike për LBR-në 2016(pasi kjo LBR ka qenë në fuqi edhe për vitin 2017), u konstatua mungesa e dorëzimit të inventarit fizik të barnave që rimbursohen në Fond përpara lidhjes së kontratës. Mosdorëzimi i këtij inventari bie në kundërshtim me pikën 8 të Kapitullit Detyrimet E Importuesit Farmaceutik, në të cilën përcaktohet qartë: *“Importuesi dorëzon (vetëdeklaracion) pranë FONDI-t inventarin e gjendjes fizike të barnave që rimbursohen, inventarin e barnave të skaduara (nëse ka), listën e barnave aneksi A, kur lidh kontratë si dhe kur hyn në fuqi lista e barnave që rimbursohen, të printuar dhe në formë elektronike si dhe autorizimin (ose kontratën) nga Mbajtësi i Autorizuar për Tregtim, vendas apo i huaj, për tregtimin e barnave në Shqipëri”*. Nga të dhënat elektronike të paraqitura elektronikisht nga DIAS sipas vetëdeklarimeve mujore të depove rezultuan pasaktësi në deklarime sipas sasive, çmimeve të aplikuara dhe vlerave përkatëse. Këto mosrakordime paraqesin një situatë të çrregullt dhe plot diferenca si në sasi ashtu edhe në vlerë. Mbi bazën e këtyre të dhënave duke u mbështetur në sasi të vetëdeklaruar dhe çmimeve të rimbursimit në listën LBR 2016 u kryen përpunimet përkatëse prej nga rezulton:

Në 11 Depo Farmaceutike të kontraktuara nga Fondi u konstatuan gjendje kontabël negative në sasinë prej (-4,279,175 copë) dhe me vlerë inventari negativ (-95,495,557 lekë). Bazuar në sa më sipër prej këtyre subjekteve nuk rezultojnë të jenë kryer deklarimet konform përcaktimeve në kontratë si për inventarin në momentin e lidhjes së kontratës ashtu edhe në deklarimet inventarit elektronik në fillim të LBR por dhe për çdo muaj të cilat nuk pasqyrojnë realisht veprimtarinë e këtyre subjekteve në përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nga ana e këtyre subjekteve bien ndesh me përcaktimet e kontratës me Depot Farmaceutike përkatësisht me pikën 8 të Kapitullit “Zgjidhja e Kontratës”. Mosrakterdime e paevidentuara nga DIAS, sipas procesverbalit mujor të kundërfirmosur nga specialisti/përgjegjësi i sektorit të Statistikës të kësaj drejtorie ,si dhe mungesa e bashkëveprimit brenda DIAS si dhe brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit kanë sjellë si pasojë planifikime të kontrolleve në depot farmaceutike dhe farmacitë e spitaleve, të pambështetur në analiza risku, duke

shmangur prioritetin e kontrolleve me inventarë në ato subjekte që përfitojnë nëpërmjet shitjes së barnave të rimbursueshme vlera të larta monetare. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 85-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

11.1 Rekomandimi: Planifikimi dhe realizimi i kontrolleve në depot farmaceutike dhe farmacitë e spitaleve, të bëhet mbështetur në nivelin e riskut që paraqitet në periudha të ndryshme, duke i dhënë prioritet kontrolleve me inventar në ato subjekte që përfitojnë nëpërmjet shitjes së barnave të rimbursueshme, vlera të larta monetare.

Në vijimësi

11.2 Rekomandimi: FSDKSH në funksion të mirëfunksionimit dhe transparencës të procesit të kontrollit të lejojë aksesin në të dhënat elektronike të Depove Farmaceutike për të gjithë punonjësit e Sektorit të Depove në FOND, akses i cili do të ndihmonte kontrollorët dhe drejtuesit e tyre me informacionin e nevojshëm për mbikëqyrje të vazhdueshme mbi subjektet, planifikim dhe realizimin e kontrolleve me efikasitet dhe efizienz si dhe për identifikimin e veprimtarisë së kundërligjshme dhe abuzive dhe parandalimin e tyre dhe për të garantuar mbikëqyrjen e plotë të zbatim të skemës së sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe përfitimet ligjore të të siguruarve nga skema.

Menjëherë

11.3 Rekomandimi: FSDKSH të ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për ndërprerjen e kontratave me subjektet të cituara në Tabelën 3.17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat kanë shkelur detyrimet kontraktuale dhe të vendosë penaltetet e pazbatuara për shumën 1,500 mijë lekë për subjektet përkatës.

Menjëherë

11.4 Rekomandimi: Të realizohet kontrolli i plotë me inventar në depot me gjendje negative të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të informohet Këshilli Administrativ lidhur me rezultatet e këtyre kontrolleve.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se;

- Me vendimin e KA-së nr.6, datë 27.01.2017 “Për krijimin e Komisionit Teknik të Barnave të Rimbursuara, për vitin 2017”, Këshilli Administrativ ka miratuar komisionin për hartimin e listës LBR 2017. Me shkresën nr. 1398 Prot, datë 21.03.2017 lista e miratuar është dërguar për procedim pranë Ministrisë së Shëndetësisë së bashku me projektvendimin për Këshillin e Ministrave dhe relacionin shoqërues. Lista e Barnave të Rimbursueshme për vitin 2017 megjithëse e miratuar me vendimin e KA-së nr.42, datë 21.03.2017 dhe e dërguar për procedim të mëtejshëm në Ministrinë e Shëndetësisë nuk rezulton e miratuar prej Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2017 duke mos hyrë efektivisht në fuqi për asnjë moment. Bazuar në dokumentacionin, vënë në dispozicion të grupit të auditimit, LBR-ja e vitit 2017 nuk ka hyrë në fuqi si rezultat i mosdakordësive të shprehura midis Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë për aspekte teknike të procedimit nga ana e Fondit në miratimin e paketës së barnave të rimbursueshme. Theksojmë që çmimet CIF të barnave të rimbursueshme të aplikuar në LBR-në 2017 kanë një rënie të përllëgaritur në masën 4.1% krahasuar me çmimet e aplikuar në LBR-në 2016. Mosmiratimi i LBR 2017 ka cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm autonominë e Fondit për administrimin e paketave të sigurimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 13 të Ligjit 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton se: “Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është i vetmi person juridik, publik, autonom, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në

Republikën e Shqipërisë” por ka krijuar pasoja negative në buxhetin e shtetit. Në gjykimin tonë mosprocedimi në kohë nga ana e Ministrive respektive për miratimin e kësaj liste ka bërë që efektivisht çmimet e ndryshuara për barna të kësaj liste të mos aplikohen. Për periudhën 9-mujore, Prill-Dhjetor 2017 në të cilën rregullisht duhet të kishte hyrë në fuqi lista e re LBR 2017 bazuar në konsumin mesatar/mujor të barnave, mos-hyrja në fuqi e saj ka sjellë efekte negative në buxhetin e shtetit në shumën e llogaritur rreth **409,000 mijë lekë**, si dhe ka ndikuar negativisht në vlerat e bashkëpagesës të personave përfitues të skemës.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 19.07.2017 Për një ndryshim në VKM nr.380, datë 25.05.2016 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH” është vendosur ndryshimi në rritje i çmimit të barit *Madopar*.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e KÇB-së pranë Ministrisë së Shëndetësisë është realizuar një vendimmarrje jashtë përcaktimeve në VKM nr. 645, duke ndjekur një ekstra-procedurë për këtë rast. Propozimi i Ministrit të Shëndetësisë në KM në rastin konkret për një ndryshim në Listën e Barnave të Rimbursueshme jo vetëm e ka anashkaluar Fondin në mënyrë të padrejtë, por e ka vendosur atë përpara faktit të kryer për përballimin e kostove shtesë.

Ky rast, në gjykimin tone përbën një precedent të gabuar, i cili ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit në shumën rreth **6,200 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 53-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

12.1 Rekomandimi: Të eliminohen praktikat e mësipërme, që kanë sjellë efekte negative për buxhetin, por edhe kanë ndikuar në paligjshmërinë e skemës së rimbursimit të barnave.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: Për vitin 2017, për shërbimin e *Check-up*, për rastet e pakryera nga koncesionari, FONDI i ka likuiduar këto raste me vlerën e plotë, duke mos marrë në konsideratë ***rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2016, sipas të cilave koncesionari duhej të ishte paguar vetëm për vlerën e shpenzimeve fikse për çdo kontroll bazë dhe jo për vlerën e shpenzimeve variabël të parashikuar që llogariten rreth 400 lekë për Check up (pa TVSH), pasi koncesionari nuk ka kosto materiale për këto raste, fakt që do të kishte ulur koston për buxhetin në vlerën 63,358 mijë lekë, (158,395 raste të pakryera*400 lekë/rast).***

Nga FONDI, vijon të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore të *Check-up*, lëshuar nga koncesionari, në vlerën totale 876,083 mijë lekë, në të cilën përfshihet edhe TVSH në masën 20% mbi vlerën e shërbimit shëndetësor, ndërkohë që ky furnizim shërbimi ***duhet të trajtohet si Furnizim i Përyshuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, sipas përcaktimit ligjor në Nenin 51 pika c) e Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar.*** KLSH i ka rekomanduar FONDIT në auditimin e mëparshëm të kërkojë interpretimin teknik nga DPT lidhur me këtë mënyrë faturimi. Interpretimi i dërguar nga DPT, në gjykimin tonë nuk paraqet frymën e ligjit, si dhe nuk përmbush kërkesat teknike për rastin konkret. Kështu që në gjykimin tonë, vijimi i praktikës së pranimit dhe likuidimit të faturave të *Check-up*, si një shërbim i tatueshëm me TVSH, ***vijon të krijojë kosto shtesë në buxhet, që për vitin 2017, llogaritet në shumën 146,014 mijë lekë, pra gjithsej efektet negative në buxhetin e shtetit llogariten në shumën 209,372 mijë lekë.*** *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, të veprohet me përgjegjshmëri të lartë lidhur me eliminimin e kostove që rëndojnë taksapaguesin shqiptar, sidomos kur këto kosto nuk reflektojnë shërbime shtesë për qytetarin.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në ligjin nr. Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20, gërma a), dhe VKM-së nr. 124, datë. 05.03.2014, “Për Miratimin e Statutit të FSDKSH”, i ndryshuar, neni 5, pika 1/a, neni 11 pika, 1/b, i kërkojmë Këshillit Administrativ, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të analizojë punën e z. E.A, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe të orientojë drejtimin për të ardhmen.

II. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Rregulloren e Funkcionimit të Brendshëm të Fondit, Kapitulli 3.3 “Rregullorja e Personelit”, si dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, z. E.A, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

Largim nga detyra për punonjësit:

1. Z. A.V, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Parësor për vitin 2017;
2. Znj. F.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Spitalore për periudhën Prill-Dhjetor 2017;
3. Znj. D.G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave për periudhën Korrik-Dhjetor 2017;
4. Z. E.D me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik për periudhën Tetor-Dhjetor 2017.

III. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Rregulloren e Funkcionimit të Brendshëm të Fondit, Kapitulli 3.3 “Rregullorja e Personelit”, si dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, Z. E.A, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore **Vërejtje për punonjësit e tjerë**, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësitë respektive të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

- **Shkarkim nga detyra** për punonjësit:

1. Z. E.M, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm për periudhën Janar-Prill 2017.

- **Largim nga detyra** për punonjësit:

1. Z. S.H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik për periudhën Janar-Prill 2017;
2. Znj. M.D, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore për periudhën Janar-Tetor 2017.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

I. Nisur nga parregullsitë e konstatuara në auditimin e ushtruar në FSDKSH për vitin 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit t’i kërkojë Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për

Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të kenë në konsideratë përjashtimin nga punësimi në shërbimin civil për një periudhë 5 vjeçare për:

1. Z. E.M, me detyrë Ish Drejtor i Përgjithshëm.
2. Z. A.V, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Parësor.

II. Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sipas pikës **D** më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G. TË TJERA

Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në vlerësim të gjetjeve dhe konkluzioneve të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe dokumentet e tjera të dosjes së auditimit, të iniciojë punën për evidentimin e shkeljeve që mund të përmbajnë elemente të figurës së veprës penale për të përcjellë më pas kallëzim apo indicje penale në organin e prokurorisë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R